



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government
Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë



Basic Education Program

SEMINARI DY MËSIMDHËNIA DHE TË MËSUARIT



giz Deutsche Gesellschaft
für Internationale
Zusammenarbeit (GIZ) GmbH

Pikëpamjet e autorit të shprehura në këtë doracak nuk i reflektojnë medoemos pikëpamjet e Agjencionit të Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar apo të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara.

Ky doracak është financuar nga populli amerikan përmes Agjencionit të SHBA-së për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID Kosovë), në kuadër të Programit për Arsimin Themelor (Basic Education Program) të USAID-it të cilin e zbaton Family Health International (FHI 360) në partneritet me Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë së Kosovës (MASHT) dhe Qendrën për Arsim të Kosovës (KEC).



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government
Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë



Basic Education Program

SEMINARI DY MËSIMDHËNIA DHE TË MËSUARIT

Mësimdhënia dhe të nxënit

'Seminari i Dytë' i adreson disa aspekte të standardeve të praktikës profesionale të drejtorëve të shkollave. Në mënyrë të drejtpërdrejtë seminari adreson standardin 2, përmes temave në vijim:

Standardi 2: Mësimdhënia dhe nxënia cilësore

- Korniza e Kurrikulës së Kosovë dhe Kurrikula Bërthamë
- Kurrikula me Bazë Shkolle
- Vlerësimi për dhe i të nxënit
- Licencimi i mësimdhënësve
- Të mësuarit e vazhdueshëm të mësimdhënësve
- Aftësimi profesional i mësimdhënësve dhe planet për zhvillim
- Vlerësimi i performancës së mësimdhënësve

Mirënjohje:

Programi për Arsim Themelor (Basic Education Program) i financuar nga Agjencioni i SHBA-së për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) dhe Qeveria e Kosovës i është mirënjohës Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH për shfrytëzimin e Programit të saj për trajnimin e drejtorëve të shkollave (2012). Gjithashtu, projekti i është mirënjohës edhe autorëve dhe bashkërenduesve të Programit të trajnimit të drejtorëve të shkollave: Dr. Hermann Scheiring, Carmen Mattheis, Selim Mehmeti, Vesel Hoda dhe Sokol Elshani. Burimi primar i këtij seminari është nga programi i GIZ-it CDBE (Capacity Development in Basic Education). Në kuadër të këtij seminari leksioni mbi “Kurrikulën e Bazuar në Shkollë” është marrë pjesërisht nga Moduli 2 i programit të GIZ-it | CDBE (Capacity Development in Basic Education) dhe pjesërisht nga dokumentet e SWAp-it. “Nxënia e mësimdhënësve është marrë nga leksioni mbi “Vlerësimin e performancës së mësimdhënësve “janë nxjerrë nga Moduli i 6 i programit të GIZ-it. Programi për Arsim Themelor i USAID-it ka kontribuar me materialin mbi “Vlerësimi i të Nxënësve dhe Vlerësimi për të Nxënë”, ndërkaq projekti “Trajnimi i mësimdhënësve dhe ngritja e kapaciteteve të komunave dhe drejtorëve të shkollave” ka përgatitur tërësisht leksionin mbi Kornizën e Kurrikulës së Kosovës. I tërë materiali i ri dhe i rishikuar është hartuar për të marrë parasysh pritjet që dalin nga udhëzimi administrativ i Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT-it), “Standardet për Praktikën Profesionale të Drejtorëve të Shkollave.” Këto standarde janë hartuar me përkrahje teknike të Programit për Arsim Themelor të USAID-it. Ky seminar është pjesë e Programit të rishikuar të trajnimit për drejtorë të shkollave. Seminarët e rifreskuara do t’i trajtojnë këto standarde si nga ana e përmbajtjes ashtu edhe nga zbatimi i tyre praktik.

Seminari u bazua në Programin e GIZ-it për trajnimin e drejtorëve të shkollave (i akredituar nga MASHT-i më 10.02.2012 me numër zyrtar 45/12 në protokollin e certifikimit të zyrës për akreditim), si dhe u rishikua nga Selim Mehmeti, Osman Buleshkaj dhe David Lynn në emër të GIZ IS në kuadër të projektit të financuar nga EU “Trajnimi i mësimdhënësve dhe ngritja e kapaciteteve të komunave dhe drejtorëve të shkollave” në bashkëpunim me ekspertët e Programit për Arsim Themelor të USAID-it. Këta ekspertë e përzgjedhën, integruan, rishikuan dhe redaktuan materialin e trajnimit për menaxhimin dhe administrimin e shkollës nga GIZ, MASHT, projekti i BE-së Qasja Ndërsektorale në Arsim (SWAp), Programi për Arsim Themelor i USAID-it dhe Programi për Zhvillimin e Mësimdhënësve në Kosovë (KEDP) me qëllim që të krijohet një material gjithëpërfshirës, i rishikuar dhe i përmirësuar. Programi i rishikuar është akredituar nga MASHT me 29.08.2012 me numër zyrtar 60/12 në protokollin e certifikimit të zyrës për akreditim.

REDAKTIMI GRAFIK

indesign

BOTIMI I PARË

Mars, 2013

PËRMBAJTJA

1. Hyrje	6
1.1. Qëllimi	6
1.2. Performanca e pritur	6
2. Korniza e Kurrikulës së Kosovës dhe Kurrikula Bërthamë	7
2.1. Nevoja për reformën gjithëpërfshirëse të kurrikulës	7
2.2. Korniza e Kurrikulës së Kosovës: Përgatitja për Ndryshim	10
2.2.1. Çka është Kurrikula e Kosovës?	10
2.2.2. Cilat janë synimet e arsimit?	10
2.2.3. Shkallët Kryesore të Kurrikulës	11
2.3. Kurrikula me bazë shkolle	12
2.4. Çka do të thotë e tërë kjo për drejtorët e shkollave?	13
3. Vlerësimi për dhe i të nxënësve	16
3.1. Përkufizimet për vlerësimin, dhe parimet e objektivat e vlerësimit	16
3.2. Llojet e vlerësimeve të kërkuara nga KKK	17
3.2.1. Vlerësimi me bazë shkolle	19
3.2.2. Vlerësimi i jashtëm	21
3.3. Pra, çka është e re?	21
4. Aftësimi i mësimdhënësve	24
4.1. Licencimi i mësimdhënësve	24
4.2. Të mësuarit e vazhdueshëm të mësimdhënësve	24
4.2.1. Besimet e mësimdhënësve	26
4.2.2. Mësimdhënësit dhe ndryshimi	26
5. Zhvillimi profesional i mësimdhënësve - disa informacione themelore	28
5.1. Zhvillimi i vazhdueshëm profesional në kuadër të shkollës	28
5.1.1. Mbështetja e kolegëve të rinj në punën e tyre	28
5.1.2. Zhvillimi profesional në vendin e punës	29
6. Licencimi i mësimdhënësve dhe vlerësimi i performancës së mësimdhënësve	30
6.1. Qëllimi i vlerësimit të performancës së mësimdhënësve	30
6.2. Dispozitat ligjore për vlerësimin e performancës së mësimdhënësve	31
6.2.1. Roli dhe përgjegjësia e palëve të përfshira në vlerësimin e performancës së mësimdhënësve	31
Referencat	34
Aneksi A - MEST AI 5/2010	35
Aneksi B - Vlerësimi për të nxënësve	43

1. Hyrje

Shkollat ekzistojnë për të përkrahur nxënësit/fëmijët në zhvillimin e potencialeve të tyre, në zhvillimin e kompetencave të të nxënit, në përgatitjen për jetë dhe në socializimin e tyre për bashkëpunim dhe ndërveprim me të tjerët. Arsimi është mjete kryesor i shoqërisë për t'i përgatitur ata për moshën madhore. Derisa ata mësojnë gjatë viteve të tyre të shkollimit nga edukimi para-shkollor deri të përfundimi i shkollës së mesme, kjo paraqet ndryshim të madh për jetën e tyre. Cilësia e rezultateve të tyre rrjedh nga ajo se çka pritet prej tyre që të mësojnë nga kurrikula, se si iu është ofruar arsimi apo përvojat mësimore që kanë mundësuar zhvillimin e të nxënit, sa mirë përkrahen ata përmes vlerësimit dhe më me rëndësi nga prindërit e tyre, mësimdhënësit dhe komunitetet dhe nga vetë motivimi i tyre për të mësuar.

Krijimi i mundësive për mësim është rol që duhet të përmbushet nga mësimdhënësi, kështu që ai/ajo duhet të dijë dhe të kuptojë:

- Se si mësojnë fëmijët
- Çka pritet të mësojnë fëmijët (kurrikula)
- Një apo më shumë lëndë që janë pjesë e kurrikulës shkollore,
- Metodologjitë për avancimin e mësimnxënies
- Gjithëpërfshirja dhe se si të reagojmë ndaj saj,
- Si të diferencohet mësimdhënia për të mundësuar gjithëpërfshirjen
- Vlerësimi për dhe i të nxënit
- Mësimi tërëjetësor, veçanërisht derisa ndërlidhet me profesionin e tyre të zgjedhur.

Njohuritë e mësimdhënësve për mësimdhënie dhe për të mësuar janë rritur jashtëzakonisht shumë gjatë mijëvjeçarit të kaluar që nga ditët e filozofëve grekë deri tek filozofët arsimor modern si Thomas Dewey, e deri të hulumtues si Andy Hargreaves (Boston College). Sot dimë lidhur me atë se si ta avancojmë mësimdhënien dhe procesin e të nxënit më shumë se kurrë në histori dhe hulumtimet vazhdojnë të zgjerojnë të kuptuarit tonë në mënyrë të jashtëzakonshme. Ata që zgjedhin të bëjnë karrierë në arsim e kuptojnë se të ofrosh shërbimin cilësor më të mirë kërkon nxënie të vazhdueshme në gjerësinë dhe thellësinë e këtij profesioni të zgjedhur.

1.1. Qëllimi

Ky seminar adreson bazat për shkollimin cilësor që ndërlidhen me përgjegjësitë e drejtorit të shkollës:

- Çka duhet të mësohet (kurrikula)
- Si mund të vlerësohet të nxënit në mënyrën më efektive
- Si të avancohet zhvillimi i mësimdhënësve; dhe
- Si të vlerësohet praktika e mësimdhënies.

1.2. Performanca e pritur

Përmes përvojës mësimore në këtë seminar nga pjesëmarrësit pritet të fitojnë këto njohuri:

- Të informohen për Kornizën e Kurrikulës së Kosovës (KKK) dhe Kurrikulën Bërthamë të Kosovës (KBK)
- Të kuptojnë implikimet e ndryshimit në praktikën e mësimdhënies i ndërlidhur me ndryshimin në KKK dhe KBK.

- Të kuptojnë opsionet sa i përket kurrikulës me bazë shkolle
- Të zhvillojnë të kuptuarit themelor të vlerësimit për dhe i të nxënësve, veçanërisht vlerësimin për të nxënësve.
- Të kuptojnë rolin e drejtorit sa i përket sistemit të licencimit të mësimdhënësve
- Të kenë të kuptuar themelor për të mësuarit e vazhdueshëm të mësimdhënësve dhe aftësimin të stafit me bazë shkolle
- Të kenë të kuptuar themelor për proceset e vlerësimit të performancës së mësimdhënësve.

Pritet që 'shkathtësitë' themelore në vijim do të mësohen nga pjesëmarrësit:

- Krijimi i një plani për të përkrahur zbatimin e kurrikulës
- Udhëzimin e mësimdhënësve dhe Këshillin Drejtues të Shkollës përmes procesit të krijimit të një kurrikule me bazë shkolle
- Përkrahja e stafit në përgatitjen e një plani dhe programi për aftësim profesional me bazë shkolle në lidhje me planin për zhvillimin e shkollës.
- Mbikëqyrja e mësimdhënësve për qëllimin e vlerësimit profesional

2. Korniza e Kurrikulës së Kosovës dhe Kurrikula Bërthamë

Hyrje

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) ka hartuar "Planin Strategjik për Arsimin në Kosovë 2011-2016." Kjo strategji ka identifikuar reformat e nevojshme për të avancuar cilësinë dhe barazinë në sistemin arsimor të Kosovës në pajtim me standardet ndërkombëtare.

Një Kurrikulë e re me përmbajtje dhe materiale të reja dhe më shumë e bazuar në qasjen me nxënësin në qendër, dhe mësimdhënien ndërvepruese do ta zëvendësojë Kurrikulën e vitit 2001. Korniza e re e Kurrikulës së Kosovës është miratuar për të udhëzuar përpjekjet e mësimdhënies aktuale dhe për të ndihmuar mësimdhënësit të përgatisin ndryshimet që po vijnë në kurrikulë. Aktualisht, MASHT është duke zhvilluar dokumentet e Kurrikulës Bërthamë për arsimin fillor, të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë në Kosovë.

2.1. Nevoja për reformën gjithëpërfshirëse të kurrikulës

Njohuritë, shkathtësitë dhe aftësitë që duhet të zhvillohen nga nxënësit për të pasur sukses në shekullin 21 kërkojnë azhurnimin e kurrikulës në Kosovë. Gjatë periudhës së izolimit të Kosovës, për arsye e rrethana të ndryshme ka ngecur cilësia e kurrikulës shkollore; teksti shkollor u bë mjeti kryesor për mësimdhënie. Në vitin 2002, Kosova miratoi kurrikulat e reja të cilat janë zbatuar vetëm pjesërisht. Tani Kosova synon të ngrihet në nivelin e standardeve evropiane dhe, rrjedhimisht, ka azhurnuar kurrikulat me përmbajtje të reja, metoda dhe materiale të reja mësimore dhe metoda të reja të vlerësimit që kanë të bëjnë me arritjen e standardeve arsimore. Drejtorët dhe mësimdhënësit janë në qendër të zbatimit të kurrikulave të reja, veçanërisht përmes aftësimin profesional të stafit me bazë shkolle. Ekziston nevoja urgjente për të ndërtuar mbi përvojat më të mira në Kosovë për të zhvilluar një qasje me konsistente dhe të unifikuar sa i përket kurrikulës dhe procesit të të nxënësve nëpër të gjitha klasat. Po ashtu ekziston nevoja për përmirësimin e menaxhimit të klasës dhe sjelljes së nxënësve.

Derisa nxënësit e Kosovës përgatiten për të jetuar e punuar në një botë gjithnjë e më të ndërvarur, është me rëndësi të adresojmë:

Çka po japim mësim;

Pse po e japim atë mësim;

Si japim mësim dhe si vlerësojmë; dhe

Sa mirë duhet të mësojnë nxënësit (standardet).

Derisa zhvillimi i kurrikulave lëndore dhe silabuseve sipas Kurrikulës Bërthamë të Kosovës (KBK) është në vazhdim e sipër, ne tashmë e kemi Kornizën e re të Kurrikulës së Kosovës (KKK). KKK paraqet themelin pasi që ajo ofron udhëzime konkrete për t'iu ndihmuar në mënyrë kreative që të merreni me:

- teknikat e ndryshme të mësimdhënies;
- çështje dhe situatat mësimore; dhe
- përkrahjen e organizimit të procesit të mësimdhënies për të mirën e nxënësve.

Si e zhvillojmë kurrikulën?

Pse ekziston nevoja për ndryshim?

Ku është Kosova në këtë proces?

Diagrami në faqen tjetër mbi “Zhvillimin e Kurrikulës” paraqet 3 burimet kryesore nga të cilat e nxjerrim kurrikulën: Nxënësit, Shoqëria dhe Lëndët. Asnjëra prej këtyre nuk qëndrojnë statike me kalimin e kohës. Nevojat ndryshojnë brenda secilës prej këtyre burimeve dhe më qëllim që të plotësohen nevojat e shekullit 21 duhet të ndryshojë edhe kurrikula. Ndryshimet e nevojshme në kurrikulë adresohen në tri mënyra të ndryshme:

1. Nga fokusi me lëndët në qendër tek fokusi në rezultate mësimore dhe i bazuar në kompetenca
2. Nga fokusi me mësimdhënësin në qendër tek fokusi me nxënësin në qendër
3. Nga metodologjia didaktike/ligjëruese në një metodologji me ndërvepruese dhe gjithëpërfshirëse

Kosova ka filluar procesin e ndryshimit të kurrikulës dhe ky dokument paraqet sfidën për Mësimdhënësit dhe Drejtorët e Shkollave që ata të fillojnë tani të përdorin KKK-në e miratuar për të udhëzuar praktikën e tyre të mësimdhënies që të përgatiten më mirë për Kornizën e Kurrikulës Bërthamë (KBK) që është në zhvillim e sipër.


Aktiviteti # 1:

Hapi i parë: Me një koleg, shikoni në diagramin në vijim dhe përpiquni të gjeni të paktën tre hapa veprimi që ju do të mund t'i filloni të shkollën tuaj. Roli juaj është që të prezantoni kurrikulën e re dhe ndryshimet që i përmban ajo. Përpiquni të jeni praktik dhe të zgjidhni aspekte që janë të lehta për fillim.

Hapi i dytë: Ndani mendimet tuaja dhe hapat veprimit me një grup të madh. Shikoni sa të ngjashëm/ndryshëm janë hapat tuaj.

ZHVILLIMI I KURRIKULËS

Burimet e kurrikulës: Nxënësit, shoqëria, lëndët



2.2. Korniza e Kurrikulës së Kosovës: Përgatitja për Ndryshim

Drejtorët e shkollave duhet të fillojnë të përgatiten dhe t'i përkrahin mësimdhënësit e tyre për ndryshimet e kërkuara nga Kurrikula e re e Kosovës edhe pse ajo nuk është duke u zbatuar ende. Megjithatë, MASHT është duke e përgatitur fazën pilotuese që pritet të fillojë në shtator të vitit 2012. Në fazën e parë, shkollat e përzgjedhura pilote do të përfshihen në rishikimin e kurrikulave aktuale (atyre të vitit 2001), silabuset dhe tekstet shkollore dhe ashtu t'i përgatisin shkollat dhe mësimdhënësit që të fillojnë me zbatimin e plotë të kurrikulës së re të bazuar në kompetenca.

2.2.1. Çka është Kurrikula e Kosovës?

Kurrikula e Kosovës përkufizohet si sistemi i tërësishëm i dokumenteve të kurrikulës që specifikojnë llojin dhe nivelin e rezultateve të pritura në lidhje me atë që do të mësohet në shkolla dhe përshkruajnë çka, kur, si (në aspekte të përgjithshme pedagogjike) do të ndodhin ato. Kurrikula e Kosovës rregullon procesin e përgjithshëm të mësimnxënies në arsimin e obliguar në Kosovë. Kurrikula e Kosovës strukturoret në dy komponentë kryesor:

- Komponenti Konceptual (që është zhvilluar tashmë) – i përfaqësuar nga Korniza e Kurrikulës së Kosovës (KKK)
- KKK merr parasysh shumë ndryshime në sistemin arsimor që nga viti 2001 kur u zhvillua kurrikula, e poashtu edhe sfidat e reja të identifikuara gjatë periudhës 2001 – 2008. Këto sfida kërkojnë që të rinjtë të zhvillojnë aftësi për të përdorur njohuritë, shkathtësitë dhe qëndrimet në kontekstin e zgjidhjes së problemeve të botës reale dhe kështu të arrijnë kompetencat e dëshiruara siç është shprehur në KKK.
- Komponenti Operacional (aktualisht në zhvillim e sipër) – i përfaqësuar nga
- Kurrikula Bërthamë e Kosovës (KBK) për nivelet formale të arsimit (nivelin fillor, të mesëm të ulët, të mesëm të lartë)
- Silabuset lëndore për Klasët 1 – 12 (që do të zhvillohen gjatë fazës pilotuese të zbatimit të kurrikulës)
- Dokumentet përkrahëse, pasi të zhvillohet Kurrikula e Kosovës do të përfshijë dokumentet përkrahëse duke përfshirë tekstet shkollore, materialet për mësimdhënie e mësimnxënie, udhëzues për mësimdhënësit, CD dhe programe kompjuterike, Materiale për Vlerësim dhe Provime dhe Veglat për Monitorim dhe Vlerësim të sigurisë së cilësisë.

Është tepër e rëndësishme që drejtorët e shkollave të luajnë rol aktiv që t'i ndihmojnë mësimdhënësit që të përgatiten për këto ndryshime dhe të jenë në gjendje që të menaxhojnë sfidat e reja duhet përfshirë qasjet e reja ndaj metodologjisë, materialet e mësimdhënies e të nxënies, çështjet ndër-kurrikulare në vlerësim, dhe praktikatat e gjithëpërfshirjes. Drejtorët e shkollave duhet t'i ndihmojnë mësimdhënësit që t'i zhvillojnë praktikatat aktuale të mësimdhënies që t'i përmbushin pritjet e reja. Kurrikula e re parashihet të jetë më në linjë me zhvillimet dhe standardet ndërkombëtare të kurrikulës dhe kjo është një sfidë tjetër me të cilën duhet të merren drejtorët e shkollave dhe stafi i tyre shkollor.

2.2.2. Cilat janë synimet e arsimit?

Vizioni i arsimit në Kosovë – siç promovohet nga Korniza e Kurrikulës së Kosovës – është që t'u mundësojë individëve të bëhen të pavarur, të jenë në gjendje ta përmbushin jetën e tyre personale dhe të kontribuojnë në progresin e vazhdueshëm, prosperitetin dhe mirëqenien e shoqërisë kosovare. Synimet kryesore që dalin nga ky vizion janë:

- Zhvillimi i identitetit fleksibil, të shumëfishtë, dhe përkatësia kombëtare e kulturore;
- Promovimi i vlerave të përgjithshme kulturore e qytetare;
- Zhvillimi i përgjegjësisë për vetën, për të tjerët, për shoqërinë dhe për mjedisin;
- Përgatitja për jetë dhe punë në kontekstin e ndryshimeve sociale e kulturore;
- Zhvillimi i ndërmarrësisë dhe përdorimit të teknologjisë
- Përgatitja për të mësuarit tërëjetësor.

Kompetencat dhe rezultatet përfundimtare (që duhet të arrihen deri në përfundim të arsimit të detyrueshëm)

Në pajtim me vizionin dhe politikat e arsimit në Kosovë që përfshihen në Kornizën për Kurrikulën e Kosovës, këto në vijim janë kompetencat kryesore të parapara për sistemin arsimor në Kosovë:

Nxënësi		
6 Kompetencat Kryesore		Rezultatet Përfundimtare
Kompetencat e komunikimit dhe të shprehurit	Që të rinjtë të bëhen	Komunikues efektive
Kompetencat e të menduarit		Mendimtar kreativ dhe kritik
Kompetencat e të mësuarit		Nxënës të suksesshëm
Kompetencat që ndërlidhen me jetën, punën dhe mjedisin		Kontribuues produktiv për Kosovën dhe shoqëritë dhe kombet tjera
Kompetencat personale		Individë të shëndoshë të cilët bëjnë zgjedhje duke u bazuar në mençuri
Kompetencat qytetare		Qytetarë të përgjegjshëm, aktiv dhe pjesëmarrës

Parimet arsimore

Korniza e Kurrikulës së Kosovës bazohet në një numër parimesh të reja që janë menduar që gradualisht ta përmirësojnë atë që ju tashmë e bëni në klasat tuaja. Janë pesë parime:

- Gjithëpërfshirja: secili fëmijë ka të drejtë për arsim cilësor;
- Qasja e bazuar në kompetenca;
- Mësimdhënia dhe mësimnxënie e integruar dhe koherente;
- Fleksibilitet dhe autonomi e shtuar në nivelin e shkollës;
- Përgjegjësia dhe llogaridhënia.

2.2.3. Shkallët Kryesore të Kurrikulës

Korniza e Kurrikulës së Kosovës është strukturuar në shkallët kryesore të kurrikulës të cilat janë harmonizuar me strukturën arsimore të arsimit parauniversitar në Kosovë.

Shkallët janë periudha prej 1-3 vjet. Shkallët e kurrikulës paraqesin kërkesat e kurrikulës dhe qasjet e mësimdhënies e mësimnxënies. Deri në fund të Shkallës së Kurrikulës, Kurrikula Bërthamë do të përcaktojë një bashkësi të:

- Kompetencave kryesore që do të arrihen;
- Kërkesat e kalimit në shkallën tjetër;

- Strukturën për të organizuar mësimdhënien e mësimnxënien; dhe
- Qasjet e vlerësimit dhe kriteret e vlerësimit.

Dizajnimi i kornizës së kurrikulës sipas shkallëve paraqet nevojën për:

- Më shumë transparencë dhe qartësi në artikullimin e qëllimeve dhe detyrave arsimore;
- Mundësinë e udhëzimeve konkrete për organizimin e aktiviteteve shkollore me theks mbi metodat specifike, rezultatet/objektivat dhe mjetet e vlerësimit;
- Pranim i karakteristikave të veçanta të fazave zhvillimore dhe të qëllimeve të veçanta të secilës shkallë të kurrikulës; dhe
- Nevoja për të rritur llogaridhënien e shkollës për cilësinë e arsimit që ofrohet në nivelin e shkollës dhe progresin e nxënësit në zhvillimin e kompetencave kryesore.

Skica në vijim ofron një pasqyrë të gjerë të shkallëve kryesore të kurrikulës:

Standardi Ndërkombëtar i Klasifikimit të Arsimit (SNKA)	Nivelet formale të sistemit të arsimit	Fazat kyçe të kurrikulës
SNKA 3	Arsimi i mesëm i lartë Klasa 12	Shkalla kryesore e kurrikulës 6: <i>Konsolidim dhe specializim</i>
	Arsimi i mesëm i lartë Klasët 10-11	Shkalla kryesore e kurrikulës 5: <i>Zhvillim i përgjithshëm dhe profesional</i>
SNKA 2	Arsimi i mesëm i ulët Klasët 8-9	Shkalla kryesore e kurrikulës 4: <i>Përforsim dhe orientim</i>
	Arsimi i mesëm i ulët Klasët 6-7	Shkalla kryesore e kurrikulës 3: <i>Zhvillim i mëtejshëm dhe orientim</i>
SNKA 1	Arsimi fillor Klasët 3-5	Shkalla kryesore e kurrikulës 2: <i>Përforsimi dhe zhvillimi</i>
	Arsimi fillor Klasët 1-2	Shkalla kryesore e kurrikulës 1 <i>Përvetësim themelore</i>
SNKA 0	Klasa para-fillore	Shkalla përgatitore e kurrikulës: <i>Edukimi në fëmijërinë e hershme</i>
	Mosha 0-5	

2.3. Kurrikula me bazë shkolle

Sipas Kornizës së Kurrikulës, kurrikula përbëhet nga dy pjesë:

1. Kurrikula Bërthamë
2. Kurrikula me Bazë Shkolle

Objekti i përbashkët i kurrikulës bërthamë dhe kurrikulës me bazë shkolle është të ndihmohen nxënësit të arrijnë gjashtë kompetencat kryesore të përcaktuara në Kornizën e Kurrikulës:

1. Kompetencat e komunikimit dhe të shprehurit
2. Kompetencat e të menduarit

3. Kompetencat e të mësuarit
4. Kompetencat e ndërlidhura me jetën, punën dhe mjedisin
5. Kompetencat personale dhe
6. Kompetencat qytetare

MASHT është tërësisht përgjegjës për Kurrikulën Bërthamë, ndërsa Kurrikula me Bazë Shkolle i takon autonomisë së shkollës brenda decentralizimit. Është paraparë që të jetë fleksibil, duke i mundësuar shkollës ta krijojë profilin e vet në interesin më të mirë të nxënësve në hapësirën ku funksionon.

Kjo është njëra nga gjërat me ngazëlluese lidhur me Kornizën e Kurrikulës së Kosovës pasi që do të jetë një mundësi për shkollat që të zhvillojë një pjesë të kurrikulës. Kjo do të jetë mundësi e madhe që ta bëjë kurrikulën më të mirë dhe më të larmishme.

Stafi mësimdhënës mund të ndërmarrin, në bashkëpunim me prindërit dhe akterët tjerë, shfrytëzim inovativ dhe fleksibil të kohës për të krijuar programe me bazë shkolle për të plotësuar nevojat, kontekstet dhe interesat e nxënësve. Këtu mund të përfshihen:

- Aktivitete shtesë të mësimdhënies e mësimnxënies që mund të ndihmojnë në arritjen e kompetencave të caktuara (d.m.th. lëndë zgjedhore, punë në projekte, shërbim në komunitet, aktivitete artistike e sportive);
- Mësimdhënia në bllok (për shembull, për një semestër, gjashtë javë apo një muaj – për lëndë që nuk kërkojnë renditje strikte të njësive);
- Kohë e zgjeruar e mësimdhënies për përdorimin e qasjeve pedagogjike ndërvepruese (siç janë orët mësimore prej 100-120 minutash në vend të atyre prej 35-45 minutash);
- Koha e ndarë për aktivitetet e kurrikulës zgjedhore
- Aktivitete përmirësuese për nxënësit që kanë vështirësi në mësimnxënie;
- Përforsimi i njohurive, shkathtësive dhe qëndrimeve në fusha të caktuara të kurrikulës;
- Ofrimi i temave/kurseve/moduleve zgjedhore të ofruara nga MASHT;
- Zhvillimi i aktiviteteve specifike për shkollën që përcaktojnë një projekt shkollor (siç janë mësimdhënia e mësimnxënia e gjuhëve; TIK-u; orientimi në karrierë);
- Zhvillimi dhe zbatimi i kurrikulave që iu përshtaten kushteve, resurseve dhe nevojave lokale;

Shkollat do ta kenë përkrahjen e shërbimeve arsimore nga nivelet qendrore e lokale gjatë zhvillimit të silabuseve me bazë shkolle për të gjitha lëndët zgjedhore. Pasi që shkollat ndërmarrin nismën lidhur me shfrytëzimin e pjesës zgjedhore të kurrikulës, ata duhet të dorëzojnë një propozim në DKA dhe MASHT për miratim përfundimtar. Pasi të miratohen Kurrikulat me Bazë Shkolle dhe silabuset me bazë shkolle, ato do të bëhen obligative për të gjithë nxënësit në shkollë; ato do të monitorohen dhe vlerësohen duke u bazuar në kritere të njëjta sikur pjesa tjetër e kurrikulës.

2.4. Çka do të thotë e tërë kjo për drejtorët e shkollave?

Kurrikula e re siguron nivel të rritur të autonomisë së shkollës për të planifikuar dhe realizuar zbatimin e kurrikulës në pajtim me kushtet specifike të stafit të saj mësimdhënës, infrastrukturën e shkollës dhe karakteristikat lokale ku funksionon shkolla. Si e tillë, kurrikula e re i mundëson secilës shkollë të ndërtojë profilin e vet në interesin më të mirë të nxënësve dhe lokalitetit ku funksionon.

Në këtë kontekst, nga shkollat pritet të rishikojnë me kujdes aftësitë dhe mangësitë e secilit nga mësime të tyre, ashtu që të shfrytëzojnë më mirë stafin mësues në dispozicion. Nga mësime të pritet të përdorin fleksibilitet të rritur për të planifikuar dhe përdorur një gamë të gjerë të metodologjive të mësimit që janë të përshtatshme për qasje ndërvetë dhe të individualizuara ndaj nxënësve drejt arritjes së rezultateve mësimore të paracaktuara.

Kjo mund të arrihet nëse në shkollë ka staf mësues të përkushtuar që të bëjnë më të mirën për nxënësit, dhe për t'iu ofruar atyre gjithëpërfshirje në sistemin e arsimit dhe po ashtu përkrahje të individualizuara për secilin nxënës për të arritur kompetencat kryesore dhe përmirësimin e potencialit të tyre.

Aktiviteti # 2.

Roli i drejtorit të shkollës është që të ofrohet udhëheqje dhe menaxhim në zbatimin e ndryshimeve në kurrikulë. Kjo është më shumë se vetëm administrimi i shkollës. Autonomia e shkollës kërkon shkathtësi dhe pikëpamje të reja. Kjo mund të shihet në dy rrafshje:

1. Puna me mësime të tjerë
2. Udhëheqja e ndryshimit

Në punën me mësime të tuaj ju duhet të merrni parasysh këtë në vijim;

- Ndryshimet në metodat dhe strategjitë e mësimit
- Ndryshimet në vlerësim
- Ofrimin e shkathtësive për mësime për të menaxhuar kurrikulën e re, duke përfshirë APM
- Vlerësimin e tërë shkollës në përgatitje për ndryshim

Në udhëheqjen e ndryshimit ju duhet të merrni parasysh;

- Shkathtësitë tuaja udhëheqëse
- Aftësinë tuaj për të menaxhuar ndryshimet e kërkuara nga KKK, veçanërisht sa i përket autonomisë së shkollës
- Punën me Këshillin Drejtues të Shkollës
- Roli i DKA-ve
- Marrëdhënia dhe komunikimi me prindërit dhe palët tjera të interesit.

Diagrami në vijim tregon sfidat që janë para jush dhe stafit tuaj. Duhet të siguroheni se stafi juaj mësues e kupton këtë dhe janë të përgatitur për ndryshim.

Roli i drejtorit të shkollës	Roli i mësimitdhënës të shkollës
<ul style="list-style-type: none"> - Siguron që shkolla të jetë një mjedis mësues miqësor, i sigurt dhe i këndshëm për nxënësit - Përfshin palët e interesit dhe partnerët e arsimit në vendimet e shkollës - Siguron mundësitë për mësimitdhënie të diferencuar si në kuadër të aktiviteteve kurrikulare ashtu edhe të atyre jashtëkurrikulare - Siguron konsistencë në tërë shkollën ("qasja e bazuar në tërë shkollën") në promovimin e mësimitdhënies me nxënësin në qendër në realizimin e tyre - Angazhohet në rrjetëzimin e shkollës për të promovuar këmbimet dhe mësimin reciprok nga praktikant efektive të mësimitdhënies e mësimitdhënies me nxënësin në qendër - Përkrahin trajnimin dhe mentorimin e mësimitdhënësve me bazë shkolle si mjet për të përmirësuar shkathtësitë e mësimitdhënies të stafit duke kombinuar aspektet teorike dhe praktike në situatat reale të jetës shkollore - Duke u bazuar në parimin e autonomisë shkollore, vendosni, në konsultim me palët e interesit, për pjesën më bazë shkolle të kurrikulës - Punon, në bashkëpunim me palët e interesit, drejt zhvillimit të një koncepti (projekti) të qartë shkollore që shpjegon vizionin dhe misionin e shkollës, e poashtu mjetet që i parashikon shkolla për të avancuar cilësinë, barazinë dhe llogaridhënien e shërbimeve arsimore - Tregoni vëmendje të veçantë në zbatimin e parimeve dhe praktikave të arsimit gjithëpërfshirës duke marrë parasysh dhe duke adresuar diversitetin dhe nevojat e ndryshme të nxënësve dhe duke luftuar kundër animeve, trajtimeve të padrejta dhe dhunës - Ndihmon shkollat që të bëhen organizata të mësimit dhe "magnete" për komunitetin përmes themelimit të komuniteteve të praktikës; programeve për arsimin e të rriturve dhe për shkrim-lexim; programe tjera të orientuara në shërbim të komunitetit. 	<ul style="list-style-type: none"> - Përdor një gamë të gjerë të metodave që iu përshtaten situatës dhe nevojës së nxënësve në kontekstin e pedagogjive ndërvepruese - Përforon lidhjet mes Fushave të Kurrikulës dhe lëndëve dhe promovon mësimin e integruar - Është në gjendje të integrojë çështjet ndër-kurrikulare, siç janë të drejtat e njeriut dhe arsimit për qytetari demokratike; edukimi për paqe; edukimi për zhvillim të qëndrueshëm; barazia gjinore; të kuptuarit ndër-kulturor; shkathtësitë jetësore; edukimi shëndetësor; arsimit ekonomik dhe ndërmarrës; arsimit për mediat; TIK dhe mësimit elektronik - Interesohet dhe është në gjendje të marrë pjesë në zhvillimin e kurrikulave dhe materialeve mësimore të personalizuara, e poashtu edhe themelimin e planeve fleksibile individuale të studimit në pajtim me parimin e autonomisë së shkollës - Posedon kapacitete për të identifikuar problemet/vështirësitë në të nxënë dhe ofron përkrahjen adekuate - Është i interesuar në vlerësimin formativ dhe të progresit me synim që të ofrojë udhëzime, këshillime, motivime dhe përkrahje për nxënësit - Komunikon mirë me nxënësit, prindërit dhe palët tjera të interesit - Lehtëson mësimitdhënien për nxënësit dhe i angazhon ata në aktivitete kuptimplote - Është i interesuar dhe në gjendje që të angazhohet në punë ekipore dhe të marrë pjesë në komunitetet e praktikës

Detyrë: Punë grupore

Në grupe prej 4-5 vetave, shikoni në tabelën e mësipërme dhe dakordohuni cilat prej këtyre me lartë janë të vërteta dhe cilat nuk paraqesin sfida. Shtoni më shumë sfida që ndërlidhen me rolin e drejtorit të shkollës dhe mësimitdhënës. Paraqisni punën tuaj para grupit të madh.

3. Vlerësimi i për dhe i të nxëniet

Aktivitet hyrës në temë: *Lexoni materialin në vijim, evidentoni risitë në komponentin e vlerësimit që dalin nga KKK dhe pasi që keni përvetësuar mirë ndryshimet filloni të përgatitni një strategji për të informuar mesimdhënësit, nxënësit dhe prindërit për vlerësimin për të nxëniet dhe vlerësimin e të nxëniet. Mund të jetë letër, broshurë ose ndonjë formë tjetër e materialeve informuese.*

Hyrje

Dy ndryshime të rëndësishme ndikojnë në punën e drejtorëve. I pari ka të bëjë me përgjegjësitë e tyre të reja sa i përket zbatimit të kurrikulës duke përfshirë edhe vlerësimin për të nxëniet dhe vlerësimin e të nxëniet të nxënësve. I dyti është përgjegjësia e tyre për të mbikëqyrë praktikën e mesimdhënësve sa i përket vlerësimit të nxëniet të nxënësve. Kjo nënkupton që drejtorët duhet të kenë të paktën të kuptuar themeloret e praktikës profesionale në lidhje me vlerësimin. Kjo njohuri është e nevojshme me qëllim që të nxiten mesimdhënësit të përdorin vazhdimisht vlerësimin për të nxëniet (vlerësimin formativ). Kjo për arsye se ai është vegël më e fuqishme për mesimdhënie se sa vlerësimi sumativ. Njohuritë bazike kërkohet për drejtorët që të sigurojnë se mesimdhënësit janë duke realizuar vlerësimin sumativ në mënyrë të duhur. Besimet e mesimdhënësve lidhur me vlerësimin shpesh shpijnë në praktika të papërshtatshme. Këto besime ekzistojnë sepse mesimdhënësit nuk janë trajnuar mirë në përdorimin adekuat të vlerësimit.

Standardi i Dytë i praktikës profesionale për drejtorët e shkollës Mësimdhënia e nxëniet cilësore kërkon që drejtori i shkollës të jetë i njoftuar dhe të kuptojë matjen dhe vlerësimin; vlerësimin për të nxëniet dhe vlerësimin e të nxëniet të nxënësve. Siç u tha në paragrafin e mëparshëm drejtorët janë përgjegjës që të *“Sigurojnë që praktikën e vlerësimit të nxënësve me bazë shkolle të jenë të përshatshme dhe të balancuara.”*

KKK promovon qasje të re të sistemit të vlerësimit të nxënësve, ku vlerësimi i nxënësve pritet të bëhet në bazë të rezultateve kryesore të fushave kurrikulare dhe rezultateve kryesore të bazuara në kompetenca. Ky sistem i vlerësimit kërkon që drejtori i shkollës vazhdimisht të jetë i informuar për procesin e vlerësimit të arritjeve të nxënësve dhe vazhdimisht të konsultohet me mesimdhënës për praktikën e reja të vlerësimit dhe për llojet e përkrahjes për nxënës për t'i ndihmuar në arritjen e kompetencave kryesore të KKK.

Për t'iu ofruar drejtorëve të shkollave njohuritë e nevojshme bazë, ky mesim rishikon:

- Përkufizimet për vlerësimin, parimet dhe qëllimet e vlerësimit
- Llojet e vlerësimit
- Përmirësimin e praktikave të vlerësimit me bazë shkolle

Fokusi është në praktikën e pritura të vlerësimit të mesimdhënësve në lidhje me të nxëniet e nxënësve.

3.1. Përkufizimet për vlerësimin, dhe parimet e objektivat e vlerësimit

Përkufizimet për vlerësimin

Vlerësimi i nxënësve është pjesë integrale e mesimdhënies dhe nxënies, përmes të cilit kuptojmë se sa nxënësit i kanë përfituar njohuritë, shkathtësitë, qëndrimet dhe vlerat në kompetencat

kryesore të të nxënimit të parapara me KKK dhe KB, apo në një fushë të kurrikulës, lëndë mësimore dhe rezultat mësimor. Korniza e Kurrikulës së Kosovës vlerësimin e përkufizon si *proces të mbledhjes së informatave dhe nxjerrjes së gjykimeve lidhur me arritshmerinë ose performancën e nxënësve*. Kjo nënkupton që vlerësimi, jo vetëm që është gjykim meritore për matjen sasiore dhe cilësore të arritjeve të nxënësve, por shërben edhe si nxitje për të nxënësit e vazhdueshëm. Një përkufizim aktual për vlerësimin:

Vlerësimi është proces i kërkimit dhe interpretimit të provave nga nxënësit dhe mësimdhënësit e tyre për të vendosur se ku janë nxënësit, ku duhet të arrijnë ata dhe si arrijnë ata më së miri. (Grupi për Reformim të Vlerësimit, 2002)

Parimet dhe qëllimet e procesit të vlerësimit

Parimet e vlerësimit. Për sistemin e arsimit parauniversitar në Kosovë, parimet e vlerësimit janë përcaktuar me Udhëzimin Administrativ të MASHT-it: Kodi i Etikës për Vlerësimin e Nxënësve. Në bazë të këtij udhëzimi, janë gjashtë parime themelore të vlerësimit që duhet të respektohen nga institucionet arsimore:

1. Respektimi i ligjit dhe parimeve demografike
2. Respektimi për individët, të drejtat e tyre dhe dallimet individuale
3. Drejtësi dhe korrektësi të barabartë për të gjithë në zbatimin e rregullave dhe procedurave të vlerësimit të nxënësve
4. Standardet më të larta të integritetit në të gjitha aspektet e procesit të vlerësimit
5. Saktësi në mbledhjen e informatave për të arriturat e nxënësve dhe raportimit të tyre
6. Promovimi i standardeve më të larta të sjelljes dhe të arritjes së të nxënësit gjatë gjithë kohës.

Qëllimet e vlerësimit. Në Kornizën e Kurrikulës së Kosovës janë të përcaktuara objektivat e vlerësimit të nxënësve në nivel të klasës dhe objektivat e vlerësimit të jashtëm.

Qëllimet e vlerësimit të nxënësve në nivel të klasës janë si në vijim:

- Planifikimi i punës së mëtejme me nxënësit
- Vlerësimi i arritjes së nxënësve, dhe
- Identifikimi i prirjeve dhe talentit të nxënësve.

Vlerësimi i jashtëm mund të bëhet për qëllimet në vijim:

- Verifikimi i cilësisë së vlerësimit në nivel klase, shkolle apo komune
- Vlerësimi i standardizuar në nivel shtetëror
- Hulumtimi
- Përdorimi të rezultateve për regjistrim në nivelet tjera të arsimit, ndryshimit të politikave arsimore, etj.

3.2. Llojet e vlerësimeve të kërkuara nga KKK

Vlerësimi i brendshëm – vlerësimi i nxënësve me bazë klase

Dy llojet më të përdorshme të vlerësimit në klasë janë:

- **Vlerësimi për nxënie – vlerësimi formativ:** mbikëqyrë përparimin gjatë procesit të të nxënësit, siguron informata kthyesë për ta lehtësuar të nxënësit dhe për ta përmirësuar mësimdhënien.
- **Vlerësimi i të nxënësit – vlerësimi sumativ:** përcakton arritjet në përfundim të një detyre të caktuar, kapitullit, gjysëmvetorit apo vitit shkollor për t'i vendosur notat dhe certifikimin e nxënësit për mësimin tërëjetësor. Përdoret edhe për ta gjykuar efektivitetin e mësimdhënies apo kurrikulës

Sipas Kornizës së Kurrikulës së Kosovës (2011), vlerësimi në nivel të klasës përfshin tri lloje të vlerësimit:

<p>1. Vlerësimi i vazhdueshëm gjatë gjithë vitit shkollor <i>Formativ&Sumativ</i></p>	<p>Përdoret për të vlerësuar të nxënit e nxënësit në ndërlidhje me një detyrë mësimore të dhënë nga mësimdhënësi.</p> <p>Mbështet në rezultatet specifike të të nxënit të përcaktuara në kurrikulë, plane dhe programe mësimore.</p> <p>Vlerësimi bëhet përmes shkallës së vlerësimit numerik që përfshin notat 1 – 5.</p>
<p>2. Vlerësimi përfundimtar– në fund të vitit shkollor <i>Sumativ</i></p>	<p>Bëhet në fund të çdo viti shkollor dhe reflekton nivelin e performancës së nxënësve gjatë një viti shkollor. Mbështet në rezultatet specifike të të nxënit të përcaktuara në kuadër të planeve dhe programeve për klasë. Vlerësimi përfundimtar me notë nxirret nga mesatarja e performancës së nxënësit gjatë gjithë vitit shkollor dhe evidentohet me nota përshtetëse nga mesatarja e nxjerrë si në vijim:</p> <p>Nota A (mesatarja prej 4.5 deri 5.00)</p> <p>Nota B (mesatarja prej 3.5 deri 4.49)</p> <p>Nota C (mesatarja prej 2.5 deri 3.49)</p> <p>Nota D (mesatarja prej 2.0 deri 2.49)</p>
<p>3. Vlerësimi sumativ në fund të shkallës së kurrikulës</p>	<p>Bëhet në fund të çdo viti shkollor i cili shënon edhe përfundimin e një shkalle të Kurrikulës (klasa 2,5,7,9,11 dhe 12).</p> <p>Vlerësimi bëhet nga lista e rezultateve të të nxënit për fushat kurrikulare të përcaktuara me Kurrikulën Bërthamë.</p> <p>Nxënësi vlerësohet në bazë të shkallës numerike 1 – 5 për nivelin e arritjes së secilit rezultat të fushave kurrikulare të përcaktuara në KB. Nota përmbyllëse (sumative) për fushën përkatëse nxirret nga mesatarja aritmetike e vlerësimit të arritjes së rezultateve të të nxënit të secilit rezultat mësimor të fushave kurrikulare. P.sh. Fusha mësimore: Gjuhët dhe komunikimi /shkalla 2 – klasat 3, 4 dhe 5 - kanë 12 rezultate mësimore. Nota sumative nxirret si në shembullin në vijim:</p> $\frac{3+4+5+3+4+5+2+5+4+5+4+3}{12} = \frac{47}{12} = 3.92 = \text{Nota B}$

3.2.1. Vlerësimi me bazë shkolle

Vlerësimi me bazë shkolle i referohet nivelit të arritjes së nxënësve në zotërimin e kompetencave kryesore, të shprehura në Kurrikulën Bërthamë për shkallët dhe nivelet e caktuara të arsimit. Organizohet nga autoritetet komunale apo nga shkolla me qëllim të vlerësimit apo vetëvlerësimit të arritjes së rezultateve mësimore për shkallë të kurrikulës dhe me qëllim të planifikimit të masave për të siguruar nivelin e domosdoshëm të zotërimin të kompetencave kryesore nga të gjithë nxënësit brenda një afati të caktuar kohor.

Vlerësimi i arritjes së rezultateve për shkallë të kurrikulës behët për secilin nxënës nga ekipi i mësimdhënësve që kanë punuar me nxënës gjatë periudhës që mbulohet me vlerësim.

Për vlerësimin e rezultateve për shkallë kurrikulare duhet që ekipi i shkollës secilin rezultat ta zbërthejë në pesë nivele të arritshmërisë në mënyrë që të vërej saktë nivelin e arritjes së secilit nxënës për rezultatin e caktuar. Më pas varësisht nga niveli i arritshmërisë të secilit rezultat planifikon aktivitete plotësuese për nxënësin që ka ngecje në arritjen e rezultatit të caktuar, përkatësisht, planifikon aktivitete shtesë për nxënësin që i ka arritur të gjitha nivelet e arritshmërisë për rezultatin e caktuar.

Shembull: Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit – Komunikues efektiv; Rezultati i të nxënës nr. 1 për shkallën parë (I): Nxënësi lexon me zë një tekst së paku prej gjysmë faqe që ka të bëjë me një temë që i përshtatet moshës së vet, të cilën ai/ajo nuk e ka lexuar me parë. Nxënësit me nevoja të veçanta arsimore për të cilët ekziston vendim për arsim me nevoja të veçanta dhe që kanë plan individual arsimor (PIA), duhet të vlerësohen sipas synimeve të përcaktuara nga PIA, por gjithmone duke u bazuar në kompetencat e përcaktuara në Kurrikulën e Kosovës.

Niveli i ARRITSHMËRISË së nxënësve		Llojet e përkrahjes së nxënësve						
1	2	3	4	5	Përkrahje përmirësuese	Mënyrat	Përkrahje për të talentuarit	Mënyrat
Nxënësit e fillon detyrën pa i hedhur një shikim të shpejtë tekstit; ai/ ajo ka vështirësi në artikullimin e shkronjave, t'i lexojë mirë shkronjave, disa fjalë, ka megjithatë vështirësi në tërësi, të lidhjes së fjalëve në fjali, etj..	Nxënësi e fillon detyrën pa i bëre një shikim të shpejtë tekstit; ai/ajo ka vështirësi në artikullimin e shkronjave, t'i lexojë mirë disa fjalë, ka megjithatë vështirësi në tërësi të rjedhshëm	Nxënësi e fillon detyrën duke i hedhur një shikim të shpejtë tekstit; ai/ajo i artikulon mirë shkronjat, fjalët lidhen në fjali; megjithatë ai nuk i fletë rjedhshëm në mënyrë të mjaftueshme	Nxënësi e fillon detyrën duke i hedhur një shikim të shpejtë tekstit; ai/ajo i artikulon shumë mirë shkronjat, fjalët lidhen në fjalitë përkatëse; lexon pa ndërprerje; megjithatë ka ca problem me të folurit e rjedhshëm	Nxënësi e fillon detyrën duke i hedhur një shikim të shpejtë tekstit; ai/ajo i artikulon shumë mirë shkronjat, fjalët lidhen plotësisht në fjalitë përkatëse; toni, shpejtësia, theksi janë në vendin e duhur; fletë shumë rjedhshëm	Mësimdhënësi vendos se si të përkrah nxënësin, ne cilin aktivitet apo çfarë aktiviteti plotësues të zhvilloje,..	Mësimdhënësi vendos çfarë metodash të aplikojë duke pasur parasysh stilin e të nxënësit	Mësimdhënësi vendos se si të përkrah nxënësin , ne cilin aktivitet apo çfarë aktivitet shtesë të zhvilloje	Mësimdhënësi vendos se çfarë metodash të aplikojë duke pasur parasysh stilin e të nxënësit

Procedura e njëjtë përdoret për zbërthimin e të gjitha rezultateve mësimore për shkallë të kurrikulës.

Vlerësimi i arritshmërisë për secilin rezultat të shkallës së kurrikulës bëhet në bazë të vlerësimit numerik 1-5, ndërsa nota sumative (A, B, C dhe D) nxirret nga vlerësimi mesatar i arritshmërisë së të gjitha rezultateve të një kompetence kryesore. Për shembull, **Kompetencat e komunikimit dhe të shprehurit – Komunikues efektiv** shkalla e 1 i ka 9 rezultate mësimore:

$$\frac{3+4+5+3+4+5+3+5+4}{9} = \frac{36}{9} = 4.00 = \text{Nota D (Mesatarja = 4)}$$

Kjo qasje e vlerësimit përfshin të gjitha kompetencat e vlerësimit të kurrikulës, d.m.th. të gjitha rezultatet mësimore të secilës shkallë të kurrikulës. Nxënësit të cilët nuk arrijnë notën 2 në një apo më shumë kompetenca të kurrikulës mund të vazhdojnë në shkallën tjetër me programe shtesë të fushës përkatëse. Pas zbatimit të programeve shtesë, nxënësit të cilët nuk e arrijnë notën 2 në një kompetencë të kurrikulës në fund të nivelit përkatës, e përsërisin klasën. Shkolla dhe mësimdhënësit vazhdojnë të ofrojnë programe për këtë grup të nxënësve në mënyrë që nxënësit të përkrahen mëtutje për të arritur zotërimin e rezultateve dhe kompetencave për atë nivel.

3.2.2. Vlerësimi i jashtëm

Vlerësimi i jashtëm i arritshmërisë së nxënësve organizohet nga autoritetet arsimore qendrore në mënyrë që të verifikohet gjendja dhe niveli i cilësisë së arsimit dhe vlerësimit me bazë shkolle, me bazë komune dhe në nivel shtetëror.

Sipas Kornizës së Kurrikulës së Kosovës, vlerësimet e standardizuara organizohen në fund të Klasëve 5, 9 dhe 12. Vlerësimit e jashtme (shtetërore) përqendrohen në matjen e nivelit të zotërimit të kompetencave kryesore.

Aktiviteti dy: Nëse pas leximit të materialin keni ndonjë paqartësi, evidentoni ato për të cilat do të dëshironit të arrini të kuptuar më të thellë. Përgatisni pyetje për shqyrtim

Pyetjet:

3.3. Pra, çka është e re?

Theksi në materialin paraprakështë në vlerësimin sumativ. Dhe është merëndësi që ai të praktikohet mirë. Por, për shumë nxënës, vlerësimi sumativ nuk nxit mësimnxënien e qëndrueshme. Ai që e nxit mësimnxënien e qëndrueshme është vlerësimi formativ apo vlerësimi për të nxënësit.

Aktiviteti tre:

Shqyrtoni skenarët në vijim dhe analizoni se si do të mund të vepronte ndryshe mësimdhënësi në këto raste.

Skenari Një

Një mësimdhënës i historisë shpesh jep ese dhe raporte si detyra për nxënës. Ai është i ndërgjegjshëm në vlerësimin e tyre me notë. Më e rëndësishme se sa rezultati në ese, për

mësimdhënësin është se nxënësit lexojnë vërejtjet e shumta që ai i shënon në punime si informata kthyese. Këto informata kthyese përfshijnë korrigjimet në aspektin gramatikor dhe në stil por më e rëndësishme ai i sfidon përfundimet e tyre kur esetë nuk kanë dëshmi për të përkrahur përfundimet. Ai poashtu shtron pyetje për nxënësit që ata të reflektojnë për to. Çfarë mund të bëj ndryshe ky mësimdhënës që t'i shtyjë nxënësit të reagojnë ndaj informatave kthyese që i jep dhe në atë mënyrë të përmirësojë cilësinë e eseve dhe raporteve të tyre?

Skenari Dy

Një mësimdhënës i shkencave ka filluar të përdor eksperimentet si mjet për t'i angazhuar nxënësit në mësimin e shkencave. Detyrat e eksperimentit për nxënësit janë të planifikuara mirë; objektivat e parapara mësimore janë të qarta dhe shumica e nxënësve i kuptojnë ato. Megjithatë, mësimdhënësi e sheh se një e treta e klasës vërtetë kanë vështirësi ta ndjekin procesin e eksperimenteve që rezultojnë me përgjigjet e tyre që janë shumë të pasakta. Mësimdhënësi është i ndërgjegjshëm në vlerësimin e detyrave me notë dhe thekson në mënyrë të qartë gabimet duke i nënvizuar me laps të kuq. Përkundër kësaj, nxënësit nuk përmirësohen. Si do të mund ta vlerësonte ai punën e nxënësve ndryshe në mënyrë që nxënësit 'ta kuptojnë' procesin? Çfarë mund të bëj mësimdhënësi që nxënësit ta kuptojnë procesin shkencor në eksperimente?

Aktiviteti i katërt: Lexoni punimin e bashkangjitur për Vlerësimin për Mësimnxënien (Aneksi B) Duke u bazuar në aneksin B rishikoni përgjigjet tuaja për Aktivitetet Dy dhe Tre. A ndryshojnë shumë përgjigjet tuaja pas leximit të punimit?

Aktiviteti i pestë: Diskutim i përbashkët mbi pyetjet vijuese


1. Diskutimet mbi përmirësimin e vlerësimit me bazë në klasë

Diskutim në grup për praktikën e përshtatshme të vlerësimit me bazë shkolle.

Grupi	Detyrat dhe pyetjet për diskutim
I	Si do të reagonit ndaj/përkrahnit një mësimdhënës në stafin tuaj nëse ai/ajo do të shprehte mendimin se vlerësimi i mësimnxënies është i mirë në parim, por zbatimi i tij në praktikë merr shumë kohë dhe nuk mund të zbatohet? Përpilo një listë udhëzimesh se si ju do të përkrahni mësimdhënësit për të planifikuar vlerësime për mësimnxënien.
II	Përpilo një listë udhëzimesh për diskutim me mësimdhënës në shkollën tuaj mbi atë si aktivitetet e mëposhtme mund t'i ndihmojnë atyre për të vlerësuar progresin e nxënësve. Vlerësimi i nxënësve <ul style="list-style-type: none"> • Vetëvlerësimi i nxënësve ose vlerësimi shoku-shokun • Rishikimi i shembujve të punës së nxënësve • Krijimi i portfolios për vlerësimin e nxënësve • Organizimi i testit

III	<p>Përpilo një listë të ideve/praktikave për mësimdhënës se si ata mund të integrojnë vlerësimin për mësimnxënie në praktikat mësimdhënëse të tyre. <i>Hartoni një shënim-koncept se si drejtori i shkollës mund të sigurojë që praktikat e vlerësimit me bazë shkolle janë të përshtatshme dhe të balancuara.</i></p>
IV	<p>Përgatit një plan orientues për zbatimin e vlerësimit me bazë shkolle (kur duhet të ndodhë, kush e bën atë, si mund të përkrahen dhe monitorohen mësimdhënësit? etj.) <i>Hartoni një instrument për vetëvlerësim si treguesin: Drejtori i shkollës siguron që praktikat për vlerësimin e nxënësve me bazë shkolle janë të përshtatshme dhe të balancuara.</i></p>
V	<p>Si do të reagoni/përkrahni një mësimdhënës nëse ai/ajo do të shprehte mendimin se standardet e vlerësimit të hartuara nga MASHT-i janë të mira në parim, por zbatimi i tyre në praktikë është vështirë të arrihet? Përpilo një listë me ide se si do t'i vetëdijesoni mësimdhënësit dhe zbatoni standardet e vlerësimit në politika (MASHT, 2011) në punën e tyre me studentë. (Grupi përdorë dokumentin: Standardet e vlerësimit)</p>

Në provincën Alberta në Kanada, Konzorciumi për Vlerësim në Alberta paraqet në mënyrë pamore të tërë procesin siç shihet në grafikonin e mëposhtëm. "Programi i studimeve" është i barabartë me 'Kurrikulën Bërthamë të Kosovës.'



SHËNIM: tekstin e përkthyer të tabelës e gjeni në shtojcën 2

4. Aftësimi i mësimdhënësve

4.1. Licencimi i mësimdhënësve

Aktivitet

Aneksi A është UA 5/2010. Cilat përgjegjësi u caktohen drejtorëve të shkollave për të zbatuar këtë politikë (udhëzim administrativ)? Cilat shkathtësi dhe njohuri duhet zhvilluar drejtorët për t'i përmbushur këto përgjegjësi?

4.2. Të mësuarit e vazhdueshëm të mësimdhënësve

(Burimi: MASHT (2012) **Të mësuarit e vazhdueshëm të mësimdhënësve: Zbatimi i asaj që mësohet në klasë**).

Hulumtuesit kanë pyetur se si mësimdhënësit në disa shkolla ndërrojnë mësimdhënien e tyre për të pasqyruar "praktikat më të mira" kurse të tjerët jo. Përgjigjja gjendet në dy fusha: angazhimi i drejtpërdrejtë i mësimdhënësve si kontribuues në procesin e ndryshimit dhe konteksti në të cilin ndodhë mësimnxënia e mësimdhënësve. Ndryshimi nuk u bëhet atyre, ai bëhet me ata.

Një arsye pse ndryshimi ka qenë i suksesshëm në (disa) sisteme është se mësimdhënësit **pritet t'i përshtatin këto ndryshime** në realitet për nxënësit e tyre. Sistemet efektive vendosin besimin tek gjykimi profesional i personelit të tyre me bazë shkolle. Ndodhin përshtatje të besueshme të mësimdhënësve sepse mësimdhënësit janë nxënës tërëjetësor, janë të përkushtuar ndaj profesionit të tyre, dhe punojnë në mjedise bashkëpunuese të cilat përqendrohen në përgjegjësitë primare të shkollës – mësimdhënien, mësimnxënien dhe zbatimin e kurrikulës.

Një bazë e fuqishme për nxitjen e të mësuarit të vazhdueshëm të mësimdhënësve është angazhimi i tyre që ta dinë se mësimnxënia avancon kapacitetet dhe kompetencat e tyre, rrit përgjegjësinë dhe autonominë profesionale të tyre dhe iu ofron atyre një bazë më të drejtë për të cilën ata do të mbahen përgjegjës.

Fullan dhe Stiegelbauer (1991) argumentojnë se pse mësimdhënësit poashtu duhet të jenë edhe nxënës:

*Ndryshimi i rëndësishëm arsimor përbëhet nga ndryshimet në besime, stilin e mësimdhënies, dhe materialet të cilat mund të vijnë vetëm përmes një procesi të zhvillimit personal në një **kontekst shoqëror**.¹* (është shtuar theksi).

Në një kulturë, si e Kosovës, ku ekziston qëndrimi se nxënia e njeriut përfundon kur ai të ketë përfunduar trajnimin formal, lind pyetja, "Çka i motivon të rriturit për të mësuar?" Knowles dhe Swanson (2011) kanë dhënë një përgjigje bindëse që ka implikime për APM:

1. *Të rriturit motivohen për të mësuar pasi që ata ndeshën me nevoja dhe interesa që të nxënit do t'i kënaq: prandaj ekzistojnë pikat fillestare të duhura për të organizuar aktivitete të mësimnxënies për të rritur.*
2. *Orientimi i të rriturve për mësim është me **jetën në qendër**; prandaj, njësitë e duhura për organizimin e mësimin për të rritur janë situatat jetësore, jo lëndët.*
3. *Përvoja është resursi më i pasur për mësimin e të rriturve; prandaj, metodologjia primare për arsimimin e të rriturve është analiza e përvojës.*

¹ Fullan, Michael me Stiegelbauer, Suzanne (1991) Kuptimi i ri i ndryshimit arsimor; OISE Press; Toronto f. 132

4. *Të rriturit kanë nevojë të madhe për të qenë të vet-drejtuar; prandaj roli i mësimdhënësit (trajtnesit) është të angazhohet në procesin e kërkimit reciprok me ta, e jo transmetimit të njohurive të tij apo saj tek ata dhe pastaj të vlerësojë pajtueshmërinë me të.*
5. *Ndryshimet individuale në mes të njerëzve rriten me moshë; prandaj, arsimimi i të rriturve duhet të bëjë oferta optimale për dallimet në stil, kohë, vend, dhe ritëm të mësimi.² f. 11/12*

Bazuar në studimin e MASHT-it, mësimdhënësit do të motivohen për të mësuar kur:

1. Ajo që duhet të mësohet plotëson nevojat e tyre ashtu si ata i kuptojnë ato;
2. Ajo që duhet të mësohet zgjedh një problem(e);
3. Ajo që duhet të mësohet është praktike; mund të aplikohet në klasë me nxënës;
4. Ajo që duhet të mësohet lidhet me atë që ata e dinë dhe bëjnë aktualisht, më atë se çka parashihet që ata të dinë dhe të bëjnë; përvoja e tyre vlerësohet dhe potenciali i tyre zgjerohet;
5. Ajo që duhet të mësohet kur të vendoset në praktikë do të rrit suksesin e nxënësve;
6. Ekzistojnë mundësi që mësimi të bëhet i vet-drejtuar.
7. Si përmbledhje, të nxënësit është relevant për nxënësit (mësimdhënësit). Të nxënësit mbahet afër praktikës.

Nxënësia, të mësuarit nuk mund t'iu imponohet të rriturve; mund të negociohet. Për arsye se nxënësia në një kontekst shoqëror përfshinë rrezikun e përhapjes tek të tjerët të asaj që njeri nuk e di ose nuk është në gjendje ta bëjë, nxënësia e të rriturve duhet të paraqitet brenda një konteksti ku ka siguri për ndërmarrje të rreziqeve. Nxënësia e rritur kanë nevojë të mësojnë në një mjedis përkrahës të përbashkët, e jo në një mjedis gjykues. Ai kërkon krijimin e marrëdhënieve të shëndosha në mes nxënësve. Përgjigjja e parë ndaj mjedisit të mësimnxënies është emocionale, jo kognitive. Prandaj, hapi i parë për të sjellë ndryshim tek të rriturit është të identifikoni dhe të merrni parasysh nevojat e tyre apo të ndihmoni të rriturit të shohin qëllimin e asaj që po iu mësohet dhe përparësitë e saj se pari si individ dhe se dyti si anëtarë të një organizate. Siç u tha, nxënësia kanë nevojë për përkrahje, pasi që ata rrezikojnë për të mësuar, posaçërisht sepse orientimi i të rriturve bazohet në aspektet praktike të cilat i shfaqin kompetencat e tyre aktuale dhe mungesën e kompetencave.

Ne e dimë se mësimdhënësit mësojnë nga përvoja, praktika e qëllimshme dhe bashkëpunimi me kolegë. Ata mësojnë nga reflektimi kritik dhe angazhimi i kolegëve duke adresuar probleme të ndërlikuara. Bashkëpunimi është bazë themelore për të ndryshuar është vazhdimësi e praktikave të reja në arsim dhe duhet të bëhet veçori themelore e secilës shkollë. Është mjet i fuqishëm t'i angazhoni mësimdhënësit që t'i identifikojnë njohuritë dhe praktikat e tyre aktuale, riformulojnë, testojnë dhe zgjerojnë supozimet e tyre lidhur me mësimdhënien dhe nxënien.

Lieberman (1995) është mjaft mirëkuptues për atë se çka duhet të bëjnë sistemet shkollore për të funksionalizuar mësimin e mësimdhënësve:

*...mësimdhënësit duhet të kenë mundësi të flasin, mendojnë, provojnë, avancojnë praktika të reja, që nënkupton se ato duhet të jenë të përfshirë në mësim, **zhvillim** (është shtuar theksi), dhe përdorim të ideve të reja me nxënës. Kjo mund të ndodhë në mënyra të ndryshme: krijimi i marrëdhënieve të reja (p.sh. mentorimi i kolegëve nga kolegët, kryera e hulumtimeve në veprim etj.); krijimi i strukturave të reja (p.sh. grupe për zgjidhjen e problemeve, ekipe për vendim marrje me bazë shkollë, rishikim përshkruar); puna në detyra të reja (p.sh. shkrimi i revistave dhe propozimeve, mësimnxënja për vlerësimin, krijimi i standardeve, analizimi dhe shkrimi i studimeve të rastit të praktikës, komunikimi përmes internetit për tema të caktuara)...*

**Mëso
duke
bërë**

² Knowles, M, S., Nolton, E. F. Swanson, R.A. (2011) Nxënësia i rritur; ElsevierInc. f. 39

dhe, eventualisht, krijimi i një kulture të kërkimeve aty ku mësimnxënia profesionale pritet, kërkohet, dhe është pjesë vazhduese e mësimdhënies dhe jetës në shkollë.³ f. 14

4.2.1. Besimet e mësimdhënësve

Besimet e mësimdhënësve krijohen në radhë të parë përmes përvojave në shkollë. Kjo gjë më shumë është rezultat i dëshmimeve të dukshme në sjellje që e tregojnë nxënësit se sa vlerësim i të nxënies apo të kuptuarit e nxënësve. Besimi i mësimdhënësit për diçka aq të rëndësishme sa aftësitë e ndryshme të nxënësve për të mësuar ka ndikim të fuqishëm në mësimdhënien e tyre dhe rrjedhimisht në rezultatet e nxënësve. Pritjet e mësimdhënësve janë prodhim i besimit të tyre dhe ne e dimë nga hulumtimet e bëra në vazhdimësi ne më shumë se katër dekadat e fundit, pritjet e mësimdhënësve për të nxënies e nxënësve ka ndikim direkt në cilësinë e rezultateve që i arrijnë ata. Besoni se nxënësit nuk mund të mësojnë dhe shumica e tyre nuk do të mësojnë; besoni se ata mundën dhe shumica prej tyre do të mësojnë.

Turner dhe kolegët, citati i të cilëve është në skicë (në faqen e mëparshme), na tregojnë se si besimet e mësimdhënësve ndryshuan në një studim:

Ne besojmë se shpërblimi më e fuqishëm për të ndryshuar besimet dhe praktikave vjen nga përgjigjet e nxënësve ndaj praktikave të reja të mësimdhënies të zhvilluara me anë të bashkëpunimit. Mësimdhënësit ishin të motivuar nga angazhimi dhe mësimi më i thellë i përmbajtjes së nxënësve. Në mënyrë që të vëmë këto ngjarje në lëvizje, megjithatë, mësimdhënësit duhet të jenë të gatshëm për sfidën e ndryshimit të praktikave të mësimdhënies dhe duhet të kenë vet efikasitet të mjaftueshëm për t'iu bërë ballë dështimeve dhe për të zgjidhur probleme.⁴

4.2.2. Mësimdhënësit dhe ndryshimi

Nxënia dhe ndryshimi janë reciproke. Mësimdhënësit janë në biznesin e nxënies përderisa shumë ndryshime të zhvilluara për sistemet shkollore dhe të varura në praktikën e mësimdhënësve nuk kanë dhënë rezultate gjatë shekullit të kaluar. Pse ka pasur 'rezistencë' nga mësimdhënësit për zhvillimin e qëndrimeve të reja, duke reflektuar në praktikave dhe besimet aktuale, duke kërkuar njohuri të reja, pikëpamje dhe shkathtësi? Arsytet janë të shumta. Hulumtuesit kanë krijuar një industri duke provuar të shpjegojnë se pse ndryshimi në shkollë ka qenë aq i vështirë. Shkaqet kryesore kanë qenë:

- Nënvlërësimi i sasisë së nxënies që kërkohet nga mësimdhënësit për ta përqaftuar dhe përdorur ndryshimin
- Dështimi për të siguruar kohë të mjaftueshme dhe të organizuar për nxënien e mësimdhënësve
- Dështimi për të siguruar infrastrukturën e nevojshme (stafi, resurset, materialet, objektet dhe pajisjet) për të kryer ndryshimin e dëshiruar
- Trajtimi i secilës iniciativë për ndryshim si të ishte mjekim i mrekullueshëm që do të shëronte të gjitha sëmundjet e arsimit
- Avancim i shumë ndryshimeve në të njëjtën kohë dhe pa qenë të lidhura në mënyrë përkatëse me një iniciativë për ndryshim me të tjerat që i kanë paraprirë asaj.
- Nënvlërësim i kulturës së shkollave (dhe ndikimi i konservatizmit të komunitetit sa i përket praktikave të mësimdhënies).

³ Lieberman, A. (1995) Praktikave që mbështesin aftësimin e mësimdhënësve: Transformimi i koncepteve të mësimin profesional in Stevens, F. (ed.) INOVACIONI DHE VLERËSIMI I ARSIMIT TË SHKENCAVE: FORUMET E VLERËSIMIT TE NSF, 1992-94; NationalScienceFoundation. f. 69 & 71

⁴ Turner, Julianne C. Christensen, Andrea dhe Meyer, Debra K. (2009) Besimet e mësimdhënësve lidhur me motivimin dhe mësimnxënien e nxënësve. f. 368

- Duke mos marrë parasysh ndikimin emocional të ndryshimit dhe shqetësimin që ai mund ta prodhojë.

Në aspektin themelor, duke pasur parasysh kontekstin, në shumë raste investimi i energjisë dhe kohës nga mësimit nuk ia ka vlejtur për ta.

Guskey përshkruan rrezikun e ndryshimit për mësimit:

...ndryshimi sjellë një masë të caktuar të shqetësimit dhe mund të jetë shumë kërcënues. Sikurse profesionistët në shumë fusha tjera, mësimit hezitojnë që të marrin praktika apo procedura të reja nëse ata nuk janë të sigurt se ato do të funksionojnë (Lortie, 1975). Të ndryshosh apo të provosh diçka të re do të thotë të rrezikosh për të dështuar. Jo vetëm që kjo do të jetë shumë turpëruese, por gjithashtu është kundër përkushtimit të fortë të shumicës së mësimit për nxënien e nxënësve. Të ndryshosh do të thotë të provosh mundësinë që nxënësit mund të mësojnë më pak se sa ata mësojnë me praktikatat aktuale.⁵

Është fenomen psiko-social se si secili individ reagon ndaj ndryshimit në mënyrë të ndryshme. Prandaj, nëse një ndryshim nuk kuptohet ose frikësohet nga ai, mund të nxisë fuqinë e mbrojtjeve shoqërore brenda stafit të shkollës që e bën shumë të vështirë për ata mësimit të cilët dëshirojnë të bëjnë ndryshimet e dëshiruara.

Aspekti ngjithës i emocioneve

Kur ndjenja e ndërlidhur me një veprim është shumë e dukshme, për shembull, një mësimit argumenton rreptë kundër një ndryshimi të propozuar arsimor në një takim me stafin, ajo ndjenjë shumë lehtë dhe vetëdijshëm përjetohet nga të gjithë ata që janë dëshmitarë në atë ngjarje. Përshtypja është se ndjenja ka 'lëvizur' nga mësimit tek ata që kanë qenë duke dëgjuar, të cilët pastaj njëjtë mund të ndihen të zemëruar.

James Chris; The Psychodynamics of Educational Change P.52

Emocioni është ngjithës dhe ka ndikim në orientimin e mësimit për ndryshimin (dhe mësimitnxënien). Ndjenjat janë një pjesë e madhe e përvojës së ndryshimit veçanërisht nëse ndryshimi sfidon shumë ndjenjat për vet-efikasitet. Ndryshimi mbi të gjitha është proces i ndryshimit të kuptimit personal për domethënien dhe besimet që kanë të bëjnë me mësimitnxënien dhe nxënien. "Pastaj ndryshimi në arsim është një kuptim i thellë emocional gjatë përvojës së mësimitnxënësve..."⁶

Dhe kështu që, për t'i angazhuar mësimitnxënësit në ndryshim MASHT-i, DKA-ja dhe drejtorët e shkollave duhet të marrin parasysh mësimit për nxënie të mësimitnxënësve dhe të respektojnë dhe shmangin kurdo që është e mundur shkaqet e dështimit të ndryshimit.

Kur e prezantoni ndryshimin, pranojeni se ai përfshin nxënien:

- Sigurohuni që të përfshini mësimitnxënësit në vendimin për ndryshim dhe çka të mësohet
- Bëni të qartë, bazuar në prova, nevojën për ndryshim dhe përfitimet që parashihet t'u ndodhin mësimitnxënësve dhe më shumë rëndësi nxënësve.
- Organizoni kohën dhe kushtet për mësimitnxënien e mësimitnxënësve ashtu që t'ia vlejë investimi i kohës dhe energjisë së mësimitnxënësve

⁵ Guskey, Thomas R. (2002): Aftësimi profesional dhe ndryshimi i mësimitnxënësve, TeachersandTeaching: TheoryandPractice, 8:3, 381-391 P. 386

⁶ MichalinosZembylas, Emocionet e Mësimitnxënësve në Kontekstin e Reformave Arsimore inHargreaves, A. Lieberman, A. Fullan, M. dhe Hopkins D. (eds.) (2011) Doracaku i Dytë Ndërkombëtar i Ndryshimit Arsimor;SpringerLink e-books P. 231

- Sigurohuni që edhe përvoja e ndryshimit edhe përvoja e mësimnxënies japin mundësi për kohë të çmueshme personale për mësimdhënësit që punojnë me kolegët e tyre dhe të tjerët.

Dhe jeni të vetëdijshëm se,

- Mësimdhënësit duhet të kuptojnë *kuptimin operacional* të ndryshimit përpara se ata ta gjykojnë atë (ndryshimi duhet patjetër të jetë praktik dhe përfitues)
- Dhe, qartësia e asaj që duhet të mësohet është proces që përfshinë edhe mësimdhënësit individual edhe grupet e mësimdhënësve. Kjo nënkupton që do të ketë ndryshime në të kuptuar që është e pranueshme me kusht që të kuptuarit të jetë konsistent me qëllimin e përgjithshëm për ndryshimin e dëshiruar.
- Ndryshimi përfshin eksperimentimin dhe, sikurse shkencëtarët, mësimdhënësit kanë nevojë për mbështetje kur dështojnë, analizojnë dështimin dhe eksperimentojnë përsëri derisa diçka e re të funksionojë.⁷

Aktivitet

Ju lutem diskutoni se çka mendoni se janë implikimet për nxënien e mësimdhënësve për të mundësuar ndryshim në kurrikulë në shkollën tuaj? Cilat janë implikimet për të cilat ju, si drejtor i shkollës, duhet të punoni më mësimdhënës që t'iu ndihmosh atyre për të mësuar dhe për t'i thyer barrierat e ndryshimit?

Ju lutem shënoni përgjigjet tuaja sepse këto do të paraqiten përsëri në Seminaret 3 & 7.

5. Zhvillimi profesional i mësimdhënësve - disa informacione themelore

Zhvillimi profesional i mësimdhënësve mund të përkrahët në kuadër të shkollës përmes një kulture të shkollës, e cila e vlerëson të nxënësit, bashkëpunimin, shkëmbimin dhe përvojat e reja. Rregullat e "Këshillit shtetëror për licencimin e mësimdhënësve" duhet të ndiqen me qëllim që zhvillim profesional i mësimdhënësve të njihet zyrtarisht.

5.1. Zhvillimi i vazhdueshëm profesional në kuadër të shkollës

Menaxhmenti i shkollës është përgjegjës për planifikimin dhe ndërmarrjen e aktiviteteve për zhvillimin e personelit sipas kërkesave dhe nevojave të personelit, DKA-s dhe MASHT-it.

1. Mbështetja e kolegëve të ri në punën e tyre
2. Mbështetja e vazhdimësisë së zhvillimit profesional në rastet e transferimit në një shkollë tjetër
3. Zhvillimi profesional në vendin e punës
 - **Studimet e pavarura dhe shkëmbimi me kolegë të tjerë**
 - **Ndryshimi i detyrave**

5.1.1. Mbështetja e kolegëve të rinj në punën e tyre

Në kuadër të shkollës këto aktivitete shërbejnë për t'i mbështetur kolegët e rinj në përfshirjen e tyre si pjesëtarë të personelit. Kjo mbështetje u ndihmon kolegëve të rinj që të orientohen më mirë në punën e re, ta njohin personelin si dhe të jenë efektiv në një kohë sa më të shkurtër.

⁷ Shumica nga çështjet në lista në faqet 13 & 14 janë përshtatur nga Fullan, Michael me Stiegelbauer, Suzanne (1991) **Kuptimi i ri i Ndryshimit Arsimor f. 127/8**

Andaj, kjo mbështetje, e quajtur po ashtu mbështetje “me rastin e nisjes së punës” nuk është një gjë luksoze, por një hap i rëndësishëm për ta bërë sa më të lehtë integrimin e personelit të ri, si dhe përfitimi nga anëtarët shtesë të personelit dhe nga kompetencat e tij/saj brenda një periudhe sa më të shkurtër kohore. Cilido pjesëtar i ri i personelit duhet të njihet me Planin zhvillimor të shkollës dhe me projektet në zbatim. Është tejet e rëndësishme që secili pjesëtar i personelit ta kuptojë gjendjen aktuale të shkollës, objektivat dhe mënyrën se si mund të arrihen ato objektiva.

Secili pjesëtar i ri i personelit duhet të njihet me këshillin drejtues të shkollës. Njoftimi duhet të përfshijë këto fusha:

- Standardet profesionale të shkollës në lidhje me përgatitjet për mësimdhënie, metoda të mësimdhënies, marrëdhëniet mësimdhënës-nxënës, qasja në informacion, detyrat e veçanta të shkollës, etj.
- Organizimi i shkollës: kalendari i konferencave dhe takimet, ndarja e detyrave në kuadër të kolektivit të mësimdhënësve, mënyrat e pjesëmarrjes në procesin e vendimmarrjes, rregullat dhe rregulloret, etj., dhe
- Rrjetet sociale në shkollë, si dhe ato joformale (kujt mund t’i drejtohen në rast se ka probleme, këshillimet mes kolegëve, etj.).

5.1.2. Zhvillimi profesional në vendin e punës

Studimet e pavarura dhe shkëmbimet me kolegë të tjerë

Studimet e pavarura janë tejet të rëndësishme në marrjen e njohurive të reja: karakterizohet me efikasitet në kosto, i përgjigjet nevojave dhe interesave të mësimdhënësit dhe mund të bëhet në çdo kohë.

Edhe prania e një biblioteke publike ose shkollore – edhe nëse është modeste, është një ndihmë e madhe. Nganjëherë, është i mundur integrimi i aspekteve të ndryshme filmike e televizive në procesin e mësimdhënies.

Një mundësi e madhe për studimet e pavarura (autodidakte) është interneti: gazetatat dhe revistat që kanë të bëjnë me një temë të caktuar mund të gjinden në gjuhë të ndryshme, janë të pranishme udhëzues të ndryshëm për mësimdhënie si dhe sugjerime për metoda didaktike e pedagogjike. Mund të ketë kurse mësimi nga distanca edhe prej universiteteve apo akademive ndërkombëtare në të cilat mund të abonojnë mësimdhënësit. Interneti është pothuaj një burim i pashtershëm i njohurive.

Shkëmbimi me kolegë të tjerë është një mënyrë e mirë për përforcimin e punës në ekip si dhe të zhvillimit të kualifikimeve dhe njohurive të kolektivit të mësimdhënësve si dhe të pjesëtarëve individualë. Në një situatë mes të barabartëve, d.m.th “mes kolegëve”, është e mundur të shkëmbehen përvoja dhe të mësohet prej njëri-tjetrit për metodat e reja të mësimdhënies, të merren përgjigje se si të përdoren programet e reja kompjuterike, të gjendet mbështetja se si të trajtohet problemi i refuzimit të vijimit të shkollës dhe braktisja, si dhe për këshilla se si të përmirësohet bashkëpunimi mes mësimdhënësve në projekte të përbashkëta, etj.

Një mënyrë mjaft efektive është ofrimi i mundësisë së hospitimit, d.m.th. të vrojtimit në klasë të procesit të mësimdhënies së zhvilluar nga një mësimdhënës koleg. Shkëmbimi është në të mirë të të dyve – vrojtuesit dhe mësimdhënësit – mësimdhënësi mund të demonstrojë ndonjë metodë të re të mësimdhënies, vrojtuesi mund të japë komente prej vrojtimit të bërë, për shembull sa i përket ndikimit të metodës së tij të re në përqendrimin dhe pjesëmarrjen e nxënësve.

Ky shkëmbim mund të bëhet përmes takimeve formale dhe joformale. Këto mund të iniciohen prej një grupi të mësimitdhënësve, të jenë pjesë e planit zhvillimor të shkollës ku janë planifikuar nga udhëheqësi i projektit, ose mund të bëhen me kërkesë të drejtorit të shkollës.

Të ftuarit e një eksperti të jashtëm, i cili do të fliste për një temë të caktuar, do ta stimulonte diskutimin dhe do t'i zgjeronte horizontet.

6. Licencimi i mësimitdhënësve dhe vlerësimi i performancës së mësimitdhënësve

Me vlerësim të performancës së mësimitdhënësve nënkuptojmë procedurën e mbledhjes sistematike të informacionit dhe të analizimit të të dhënave se po i kryejnë aktivitetet e planifikuara mësimitdhënësit dhe nëse po i përmbushin përgjegjësitë dhe detyrat e tyre, si po zhvillohet institucioni dhe mësimitdhënësi në raport me synimin, qëllimet, dhe objektivat e organizatës/institucionit dhe individit/mësimitdhënësit. Vlerësimi i performancës së mësimitdhënësve është një proces i rëndësishëm, posaçërisht kur është një prej kriterëve në licencimin e mësimitdhënësit⁸.

Në udhëzimin administrativ për "Licencimin e mësimitdhënësve" vlerësimi i mësimitdhënësve është përkufizuar si vijon:

Vlerësimi - e mat cilësinë dhe vlerën e mësimitdhënies sipas standardeve të përcaktuara apo procesit të meritave dhe të arriturave të mësimitdhënësit mbi bazën e standardeve, kriterëve dhe procedurave në fuqi.

Ndërsa koncepti i performancës përkufizohet në këtë mënyrë:

Performanca- Tërësia e punës dhe e rezultateve të punës së mësimitdhënësve, administratorëve arsimorë dhe të bashkëpunëtorëve profesionalë.

Vlerësimi i performancës së mësimitdhënësve është proces që lidhet ngushtë me fushën e cilësisë së shkollës, në mënyrë të veçantë me arsimin kulturor, cilësinë e mësimitdhënies dhe të nxënies, si dhe me zhvillimin profesional të mësimitdhënësit.

Duke u bazuar në *vlerësimin e performancës së mësimitdhënësit – kriteret dhe procedurat*, të hartuara nga Sistemi kombëtar i licencimit të mësimitdhënësve të vitit 2010, niveli i vlerësimit të përgjithshëm të performancës përbëhet prej katër niveleve:

- **Performancë e shkëlqyer:** performancë që vazhdimisht shkon përtej pritjeve në raport me zotërimin e kompetencave,
- **Performancë e mirë:** performancë e cila vazhdimisht i përmbushë pritjet në raport me zotërimin e kompetencave,
- **Performancë e kënaqshme:** performancë e cila në masë të madhe i përmbush pritjet në raport me zotërimin e kompetencave. Performanca e tillë mund të përmirësohet.
- **Performancë jo e kënaqshme:** performancë e cila nuk i përmbush pritjet në raport me zotërimin e kompetencave. Një performancë e tillë ka nevojë për përmirësim.

6.1. Qëllimi i vlerësimit të performancës së mësimitdhënësit

Vlerësimi i performancës së mësimitdhënësit fokusohet në vlerësimin e standardeve profesionale dhe kompetencat e mësimitdhënësit përmes treguesve të performancës të cilët e përcaktojnë nivelin e performancës të cilin e ka ai mësimitdhënës.

⁸ Udhëzim Administrativ, Licencimi i mësimitdhënësve, Nr. 5/2010, MASHT

Qëllimi kryesor i vlerësimit të performancës⁹ është:

- Të sigurojë që nxënësit të përfitojnë nga shkolla ku mësimdhënësit punojnë me nivel të mjaftueshëm të kompetencës,
- Të sigurojë vlerësim të performancës i cili është i drejtë, efektiv dhe i krahasueshëm për secilin mësimdhënës,
- Të nxisë zhvillimin profesional.

Korniza e vlerësimit të performancës së mësimdhënësit përfshinë:

KATEGORIA	PËRSHKRIMI
Standardet e profesionit	Përshkrim i përgjithshëm i profesionit të mësimdhënësit
Kompetencat	Njohuritë, zakonet dhe shkathtësitë
Treguesit e performancës	Informacioni i cili nevojitet për verifikimin e kompetencave
Niveli i performancës	Performanca sipas kompetencave
Niveli i vlerësimit	Vlerësimi i përgjithshëm i performancës së mësimdhënësit

Vlerësimi i performancës së mësimdhënësit shkon përtej nevojës për ta përcaktuar gjendjen e cilësisë së mësimdhënësve. Ajo përfshinë aspekte të licencimit dhe të promovimit në karrierë, andaj në pjesën në vijim do të paraqiten disa aspekte të dispozitave ligjore, qëllimi dhe roli i drejtorit të shkollës në monitorimin e performancës së mësimdhënësit.

6.2. Dispozitat ligjore për vlerësimin e performancës së mësimdhënësve

Vlerësimi i performancës së mësimdhënësve – kriteret dhe procedurat, i hartuar nga Sistemi kombëtar i licencimit të mësimdhënësve, është ende një dokument pune i cili do të përfundohet së shpejti pas fazës së pilotimit të procesit të vlerësimit të performancës së mësimdhënësve në shkollat e përzgjedhura pilot.

Udhëzimi administrativ për licencimin e mësimdhënësve¹⁰ i parasheh dy lloje të licencave të cilat mund t'u jepen mësimdhënësve:

- **Licenca e përkohshme** – e cila mund t'u jepet mësimdhënësve fillestarë dhe të pakualifikuar
- **Licenca e rregullt** – e cila mund të ndahet në katër lloje të licencave: licenca e mësimdhënësit të karrierës; licenca e mësimdhënësit të avancuar; licenca e mësimdhënësit mentor dhe; licenca e mësimdhënësit të merituar

Sipas këtij udhëzimi administrativ, përveç kriterëve të tjera (si orët nga programet themelore dhe plotësuese, vitet e përvojës së punës, kualifikimet, etj) në varësi të llojit të licencës, mësimdhënësit duhet të kenë një raport pozitiv të vlerësimit të performancës me qëllim që ta marrin licencën.

6.2.1. Roli dhe përgjegjësia e palëve të përfshira në vlerësimin e performancës së mësimdhënësit

Një formë e përmbledhur e ndarjes së detyrave mes qeverisë qendrore dhe lokale është paraqitur në vijim:

⁹ Vlerësimi i performancës së mësimdhënësve – kriteret dhe procedurat, i hartuar nga Sistemi kombëtar i licencimit të mësimdhënësve në vitin 2010.

¹⁰ Udhëzimi administrativ, licencimi i mësimdhënësve, Nr. 5/2010, MASHT

- ⇒ Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë (MASHT) – ku MASHT-i e paraqet draftin e sistemit të vlerësimit të performancës së mësimdhënësve dhe e menaxhon atë përmes njësisë së veçantë teknike – Njësia e Vlerësimit të Performancës (për të cilën janë dhënë detaje më poshtë), siguron fonde për vlerësimin e performancës dhe i vë në dispozicion të kësaj njësie, si dhe sigurohet që vlerësimi i performancës është zhvilluar në pajtim me ligjin.
- ⇒ Drejtoria komunale e arsimit– e cila merr vendimin përfundimtar sa i përket nivelit të performancës sipas vlerësimit të bërë nga MASHT-i.

Palët që përfshihen në procesin e vlerësimit të performancës së mësimdhënësve janë:

- (a) Mësimdhënësit. – të cilët duhet të ofrojnë fakte në lidhje me mësimdhënien, përmes portfolios dhe monitorimit të orëve të mësimin, dhe të hartojnë një raport vetë-vlerësues.
- (b) Drejtori i shkollës. – i cili duhet të bëjë analiza të raportit vetë-vlerësues dhe t'i intervistojë mësimdhënësit para se ai/ajo ta plotësojë formularin e vlerësimit. Sipas nevojës, drejtori i shkollës mund të shoqërohet nga DKA-ja përkatëse apo përfaqësuesi i tij/saj, ose të zëvendësohet nga ndonjëri prej tyre.
- (c) Drejtoria komunale e arsimit – e merr vendimin përfundimtar për nivelin e performancës sipas raportit të vlerësimit. Kjo mund të realizohet përmes një komisioni të veçantë. Niveli i performancës i përcaktuar sipas vendimit të DKA-s nuk mund të ndryshojë më shumë sesa një notë prej nivelit të performancës së propozuar në raportin e vlerësimit.
- (d) Inspektimi – duhet të sigurojë që procesi i vlerësimit të performancës të kryhet me sukses. Inspektori mund të nis një rishikim të vendimit të vlerësimit të performancës në bazë të iniciativës së palës së pakënaqur, ose në bazë të nënshkruesve të peticionit të autorizuar sipas ligjit.

Procesi i përgjithshëm i vlerësimit të performancës së mësimdhënësve duhet të bëhet përmes hapave në vijim:

Metoda	Pikët	Procesi
Vetëvlerësimi nga mësimdhënësi	10 pikë	<i>Është performancë e bazuar në një pyetësor standard, i përpiluar enkas për këtë qëllim. Mësimdhënësi reflekton për performancën e tij/saj, duke i vlerësuar aspekte të ndryshme të performancës.</i>
Vlerësimi nga drejtori i shkollës	25 pikë	<i>Drejtori i shkollës e mbështet vlerësimin e tij në raportin vetë-vlerësues të mësimdhënësit si dhe në bazë të të dhënave të mbledhura gjatë periudhës së vlerësimit. Drejtori do ta bëjë një intervistë me mësimdhënësin. Në këtë proces, drejtori mund të shoqërohet nga drejtori komunal i arsimit ose përfaqësuesi i tij ose të zëvendësohet nga njëri prej tyre.</i>

Monitorimi i orëve të mësimit	25 pikë	Ekzistojnë dy mundësi për organizimin e monitorimit të orëve të mësimit: 1) prania në klasë e monitoruesit i cili është deleguar nga Njësia e Vlerësimit të Performancës, dhe 2) vlerësimi në bazë të video-incizimit. Në rast të opsionit të dytë, personat të cilët do të incizojnë duhet të jenë trajnuar me qëllim të ofrimit të materialeve cilësore për vlerësuesin.
Vlerësimi i portfolios	40 pikë	Portfolio paraqet dokumentacionin e strukturuar me aktivitete të vlerësimit gjatë një periudhe të caktuar kohore për vlerësim. Duhet të hartohet një doracak me udhëzime gjithëpërfshirëse për përgatitjen e portfolios në mënyrë që materialet e përgatitura të jenë relevante dhe t'i mundësojnë autoritetit përkatës t'i arrijë përfundimet.

- (e) Njësia e Vlerësimit të Performancës – kjo njësi/seksion do të jetë pjesë e MASHT-it dhe do të merret me aspektet teknike të organizimit të procesit, si: përpilimi i orarit të vlerësimit, monitorimi i orëve të mësimit, vlerësimi i portfolios, bashkërendimi i aktiviteteve në terren, etj. Disa prej këtyre kompetencave mund t'u delegohen subjekteve të tjera publike dhe private, të cilat veprojnë në emër të njësisë në fjalë.

Referencat

- Kuvendi i Kosovës (2011) Ligji për arsimin parauniversitar në Republikën e Kosovës nr. 04/L-032.
- Kuvendi i Republikës së Kosovës (2008): Ligji për arsimin në komunitet e Republikës së Kosovës nr. 03/L-068.
- College of Alberta School Superintendents (2008) *Leading Assessment* – position paper
- Fullan, M. & Hargreaves, A. (eds.) (1992) *Teacher Development and Educational Change* The Falmer Press London, Washington, D.C.
- Guskey, Thomas R. (2002): *Professional Development and Teacher Change*, *Teachers and Teaching: Theory and Practice*, 8:3, 381-391
- Knowles, M. S., Nolton, E. F. Swanson, R.A. (2011) *The Adult Learner*; Elsevier Inc.
- Lieberman, A. (1995) *Practices that Support Teacher Development: Transforming Conceptions of Professional Learning* in Stevens, F. (ed.) *INNOVATING AND EVALUATING SCIENCE EDUCATION: NSF EVALUATION FORUMS, 1992-94*; National Science Foundation.
- Malik, Fredmund (2001): *Führen, Leisten, Leben. Wirksames für eine neue Zeit* Management. Heyne Business.
- Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë (2004): *Korniza për Standardet e praktikës profesionale për mësimdhënësit e Kosovës*.
- Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë (2010): *Kriteret dhe procedurat për vlerësimin e performancës së mësimdhënësve* (2010).
- Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë (2010): *Udhëzimi administrativ për licencimin e mësimdhënësve*.
- Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë (2011): *Korniza e kurrikulumit për arsimin parafillor, fillor dhe të mesëm, Prishtinë*.
- Standardet e praktikës profesionale për drejtorë të shkollave-UA 4/2012
- Turner, Julianne C. Christensen, Andrea and Meyer, Debra K. (2009) *Teachers' Beliefs about Student Learning and Motivation* in L.J. Saha, A.G. Dworkin (eds.), *International Handbook of Research on Teachers and Teaching*, 361–371. Springer Science + Business Media LLC 2009
- C.F. Webber and J.L. Lupart (eds.), (2011) *Leading Student Assessment*, *Studies in Educational Leadership* Vol. 15, © Springer Science + Business Media B.V
- Jim Brandon and M. Quarin-Wright; *Leading Student Assessment* (Chapter 4)
- Susan M. Brookhart; *"Teacher Feedback in Formative Classroom Assessment"* (Chapt. 10)
- Sherry Bennett and Dale Armstrong; *Putting the Focus on Learning: Shifting Classroom Assessment Practices* (Chapter 13)

Aneksi A – MEST AI 5/2010



Republika e Kosovës
 Republika Kosova - Republic of Kosovo
 Qeveria –Vlada – Government
 Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë - Ministarstva Obrazovanja Nauke i
 Tehnologije -Ministry of Education Science & Technology

Kabineti i Ministrit /Kabinet Ministra /Cabinet of the Minister

UDHËZIM ADMINISTRATIV
LICENCIMI I MËSIMDHËNËSVE
NUMËR: 5/2010
DATË: 27.04.2010

Në mbështetje të nenit 93 (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, neneve 12.5, 32.1, dhe 32.2 të Ligjit për arsimin fillor dhe të mesëm në Kosovë, si dhe paragrafit 7 të nenit 25 të Rregullores së Punës të Qeverisë së Kosovës nr. 1/2007, Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe Teknologjisë nxjerr këtë Udhëzim administrativ:

Neni 1
Qëllimi

1. Përmes këtij Udhëzimi administrativ (më tutje në tekst "UA"), Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë (më tutje në tekst "MASHT") krijon një sistem koherent të licencimit dhe të avancimit në karrierë të mësimitdhënësve mbi bazën e kualifikimit, përvojës, zhvillimit profesional dhe performancës si dhe krijon strukturën e pagesave përkitazi me këtë sistem.

Neni 2
Definicionet

1. "Personel i mësimitdhënës" – janë menaxherët dhe administratorët (drejtorët, zëvendës drejtorët, individët përgjegjës për ndërrime, sekretarët), dhe bashkëpunëtorët profesional (psikologët, punëtorët social, bibliotekarët).

2. "Diploma" – certifikatë apo dëshmi që vërteton diplomimin/kualifikimin nga shkolla normale, shkolla e lartë pedagogjike apo fakulteti përkatës në institucionet e arsimit të lartë në Kosovë, apo edhe institucionet jashtë vendit e që kanë kaluar nëpër procesin e njohjes së diplomave të tyre sipas dispozitave në fuqi në Kosovë.

3. "Fakultetet arsimore" – janë fakultete që ofrojnë programe të profilit arsimor ku përfshihet komponenta akademike, pedagogjike/arsimore dhe praktika e mësimitdhënies

- 4. "Fakultetet joarsimore"**– janë fakultetet që nuk ofrojnë programe të profilit arsimor për përgatitjen e mësimitdhënësve (fakultetet teknike, fakulteti i mjekësisë, fakulteti ekonomik etj).
- 5. "Licenca"**– leja e punës e lëshuar në bazë të standardeve dhe normave të miratuara paraprakisht për punëtorët e arsimit për të punuar në institucionet e arsimit parauniversitar.
- 6. "Licencimi"** – procesi i lëshimit të lejeve për ushtrimin e punës së mësimitdhënësit dhe detyrave tjera në shkollë.
- 7. "Mësimitdhënës i pakualifikuar"**– personi që ushtron profesionin e mësimitdhënësit, i cili nuk ka përfunduar shkollimin e nevojshëm universitar sipas Shtojcës I të këtij UA.
- 8. "Programet themelore të trajnimit"** –programe të zhvillimit profesional të akredituara nga institucioni i autorizuar që fokusohen në çështjet lidhur me mësimitdhënien dhe mësimitnxënien moderne. Këto programe mund të përfshijnë edhe programet e kërkuara nga MASHT për të siguruar zbatimin e reformave të caktuara në mësimitdhënie dhe/ose shkollë në përgjithësi zakonisht lidhur me ndryshimin e mësimitdhënies dhe mësimitnxënies në shkollë duke përfshirë mësimitdhënien e lëndëve të caktuara.
- 9. "Programet plotësuese të trajnimit"** –programe të zhvillimit profesional të akredituara nga institucioni kompetent që nuk ndërlidhen drejtpërdrejtë me metodologjitë e mësimitdhënies por janë në interes të ambientit të shkollës dhe shkollimit në përgjithësi.
- 10. "Vlerësimi"** – Gjykimi i cilësisë dhe i vlerës së mësimitdhënies, i bazuar në standardet e përcaktuara apo procesi i gjyimit të meritave dhe të arriturave të mësimitdhënësit mbi bazën e standardeve, kritereve dhe procedurave në fuqi.
- 11. "Mësimitdhënës pa arsimim pedagogjik/arsimor (gjatë studimeve)"** – personi që ka diplomë nga fakultetet joarsimore, siç janë fakultetet teknike, fakulteti i mjekësisë, fakulteti i ekonomisë, fakulteti juridik, etj, që nuk ka vijuar aftësim pedagogjik/arsimor.
- 12. "Mësimitdhënës"**-personi që ushtron procesin e edukimit dhe të arsimimit në institucionet e arsimit parauniversitar (edukatorët e arsimit parashkollor 3-6 vjeç, motrat edukatore që punojnë me fëmijët e moshës 0-3 vjeç, mësimitdhënësit e shkollës fillore, mësimitdhënësit e shkollës së mesme të ulët, mësimitdhënësit e shkollës së mesme të lartë dhe instruktorët që mund të kenë edhe kualifikim jouniversitar, por, që në shkollat profesionale janë përgjegjës për drejtimin e pjesës praktike të punës së nxënësve).
- 13. "Mësimitdhënës fillestar"**– mësimitdhënësit që kanë kualifikimet përkatëse për vendin e punës dhe punësohen për herë të parë. Mësimitdhënësi që kthehet në mësimitdhënie pas një pauze më të vogël se pesë vite nuk konsiderohet fillestar dhe kalojnë menjëherë në licencën e rregullt të mësimitdhënësit të karrierës.
- 14. "Performancë"**-Tërësia e punës dhe rezultateve të punës së mësimitdhënësve, administratorëve arsimorë dhe të bashkëpunëtorëve profesional.
- 15. "Niveli 0 i ISCED"**- Edukimi parashkollor (mosha 0 deri në 6 vjeç)
- 16. "Niveli 1 i ISCED"** - Shkollimi fillor (faza e parë e arsimit fillor) për pesë vite (zakonisht nga mosha 6);
- 17. "Niveli 2 i ISCED"** - Shkollimi i mesëm i ulët (faza e dytë e arsimit themelor) për katër vite (zakonisht nga mosha 12);
- 18. "Niveli 3 i ISCED"** – Shkollimi i mesëm i lartë për 3 vite (zakonisht nga mosha 15), duke përfshirë gjimnazin, shkollat profesionale, shkollat e muzikës, artit.

Neni 3

Detyrat dhe përgjegjësitë e MASHT-it në fushën e licencimit

1. MASHT-i ka detyrë dhe përgjegjësi:

1.1. Të përcaktojë kriteret dhe standardet e përgatitjes dhe kualifikimit profesional që një person duhet t'i plotësojë për të marrë licencën për mësimdhënës.

1.2. Të krijojë një sistem licencimi, i cili do të inkurajojë mësimdhënësit e pakualifikuar të kualifikohen dhe mësimdhënësit e kualifikuar dhe të licencuar të rrisin kompetencat dhe kualifikimet, duke i shpërblyer dhe nxitur ata të mësojnë gjatë gjithë jetës në profesionin e edukimit dhe të arsimit.

1.3. Të themelojë Këshillin Shtetëror për licencimin e mësimdhënësve që do të zhvillojë dhe monitorojë politikat dhe praktikat e licencimit si dhe miratojë programet e zhvillimit profesional.

1.4. Të krijojë sistemin e pagesës të bazuar në nivelin e shkollimit, në rezultatet e treguara në punë, në përparimin në karrierë dhe në përvojën e punës.

1.5. Të përkrah materialisht dhe financiarisht asociacionet dhe institucionet që merren me trajnimin e mësimdhënësve.

1.6. Të angazhohet për avancimin dhe përmirësimin e përhershëm të gjendjes sociale dhe financiare të punëtorëve të arsimit në Kosovë, përmes ofrimit të sistemit të stimulimit dhe të fuqizimit pozitiv e sistematik të tyre.

1.7. Të bëjë analiza të hollësishme të funksionalitetit të sistemit të licencimit çdo katër vite si dhe të përgatis ndryshimet e nevojshme për avancimin dhe funksionalizimin e mëtejshëm të sistemit.

1.8. Të zhvillojë databazën e licencimit që do të përcjellë mësimdhënësit individual dhe progresin e tyre në sistemin e licencimit.

1.9. Të sigurojë që institucionet e arsimit të lartë që ofrojnë programe për shkollimin e mësimdhënësve në Kosovë, respektojnë Standardet për Programet që shkollojnë mësimdhënës në Kosovë dhe plotësojnë kërkesat e specifikuar në Shtojcën I të këtij UA ose dispozitat e tjera në fuqi.

Neni 4

Sistemi i licencimit të mësimdhënësve

1. Asnjë mësimdhënës nuk mund të mbajë mësim në shkollat publike dhe private të Kosovës pa licencë që është lëshuar përmes këtij UA.

Neni 5

Kategoritë e mësimdhënësve që do të licencohen

1. Përmes këtij UA do të licencohen mësimdhënësit që punojnë në nivelin 0,1,2 dhe 3 të ISCED-it.

Neni 6

Llojet e licencës sipas kategorive të personave të licencuar

1. Në këtë UA parashihen licencat në vijim:

1.1. Licenca e përkohshme.

1.2. Licencë e rregullt.

Neni 7

Licenca e përkohshme

1. Licenca e përkohshme lëshohet për kategoritë e mësimdhënësve në vijim:

1.1. Mësimdhënësit fillestar;

1.2. Mësimdhënësit të pakualifikuar.

Neni 8

Kriteret për avancim nga licenca e përkohshme në licencë të rregullt

1. Mësimdhënësit me licencë të përkohshme sipas nenit 7.1 duhet të plotësojnë 30 orë trajnim nga programet themelore dhe duhet të kenë një vlerësim pozitiv nga shkolla.

2. Mësimdhënësit me licencë të përkohshme sipas nenit 7.2 duhet të plotësojnë kërkesat për t'u bërë mësimdhënës i kualifikuar sipas Shtojcës I të këtij UA dhe të kenë një vlerësim pozitiv nga shkolla.

Neni 9

Kohëzgjatja e licencës së përkohshme

1. Licenca e përkohshme do të lëshohet për një periudhë 1- vjeçare.

2. Nëse mësimdhënësit me licencë të përkohshme nuk i plotësojnë kërkesat e nevojshme të specifikuar në këtë UA (neni 8), atyre do t'u jepet edhe një vit shtesë. Nëse përsëri nuk plotësojnë kërkesat atëherë do t'u merret licenca.

Neni 10

Llojet e licencës së rregullt

1. Janë katër lloje të licencës së rregullt:

1.1. Licenca e mësimdhënësit të karrierës;

1.2. Licenca e mësimdhënësit të avancuar;

1.3. Licenca e mësimdhënësit mentor;

1.4. Licenca e mësimdhënësit të merituar.

Neni 11

Licencimi i mësimdhënësve aktual që janë në marrëdhënie pune

1. Mësimdhënësve të kualifikuar, që kanë së paku një vit përvojë pune e që janë në marrëdhënie pune në datën kur ky UA hyn në fuqi u lëshohet licencë e rregullt e mësimdhënësit të karrierës.

Neni 12

Avancimi në karrierë

1. Të gjithë mësimdhënësit kanë të drejtën e avancimit në sistemin e licencimit sipas dispozitave të këtij UA.

Neni 13

Kriteret për lëshimin e licencës së mësimdhënësit të karrierës

1. Licenca e mësimdhënësit të karrierës u lëshohet të gjithë mësimdhënësve të cilët i plotësojnë kriteret e specifikuar në nenin 8 të këtij UA.

2. Licenca e mësimdhënësit të karrierës duhet të ripërtërihet pas çdo pesë vitesh me kusht që mësimdhënësi të tregoj rezultate pozitive të performancës (niveli: performancë e kënaqshme

në kuptim të shkallës së vlerësimit të performancës të përcaktuar me Udhëzimin administrativ përkatës) dhe të ketë përfunduar 100 orë trajnim gjatë kohës së mbajtjes së licencës së karrierës (prej tyre së paku 70 orë nga programet themelore të trajnimit, ndërsa të tjerat nga programet plotësuese të trajnimit).

3. Në rast se mësimdhënësit në posedim të licencës së rregullt të karrierës nuk plotësojnë kërkesat e specifikuar në nenin 13.2 atyre u jepet një vit shtesë për plotësim të këtyre kërkesave. Në rast se këto kërkesa nuk plotësohen përsëri atyre iu merret licenca.

Neni 14

Kriteret për lëshimin e licencës së mësimdhënësit të avancuar

1. Licenca e mësimdhënësit të avancuar mund t'i lëshohet mësimdhënësit i cili plotëson këto kërkesa:

- 1.1.** posedon licencë të mësimdhënësit të karrierës së paku në një periudhë prej pesë vitesh;
 - 1.2.** ka përfunduar së paku 300 orë trajnim gjatë karrierës, prej tyre së paku 200 orë trajnim nga programet themelore;
 - 1.3.** tregon rezultate pozitive të performancës (së paku nivel të mirë të performancës në kuptim të shkallës së vlerësimit të performancës të përcaktuar me Udhëzimin administrativ përkatës).
- 2.** Licenca e mësimdhënësit të avancuar është valide për 5 vite dhe ripërtërihet pas vlerësimit të performancës (mësimdhënësi tregon së paku nivel të mirë të performancës në kuptim të shkallës së vlerësimit të performancës të përcaktuar me Udhëzimin administrativ përkatës).

Neni 15

Kriteret për lëshimin e licencës së mësimdhënësit mentor

1. Licenca e mësimdhënësit mentor mund t'i lëshohet mësimdhënësit që plotëson këto kërkesa:

- 1.1.** posedon licencë të mësimdhënësit të avancuar në një periudhë prej së paku 5 vitesh;
 - 1.2.** ka përfunduar së paku 450 orë trajnim gjatë karrierës, nga këto së paku 250 orë nga programet themelore të trajnimit, ndërsa të tjerat nga programet plotësuese të trajnimit;
 - 1.3.** tregon rezultate pozitive të performancës (nivel i shkëlqyeshëm i performancës në kuptim të shkallës së vlerësimit të përcaktuar me Udhëzimin administrativ përkatës);
 - 1.4.** ofron një rekomandim të shkruar nga drejtori i shkollës.
- 2.** Licenca e mësimdhënësit mentor është valide për 5 vite dhe ripërtërihet pas vlerësimit pozitiv të performancës (tregon nivel të shkëlqyeshëm të performancës në kuptim të shkallës së vlerësimit të performancës të përcaktuar me Udhëzimin administrativ përkatës).

Neni 16

Kriteret për lëshimin e licencës së mësimdhënësit të merituar

1. Licenca e mësimdhënësit të merituar mund t'i lëshohet mësimdhënësit që plotëson këto kërkesa:

- 1.1.** posedon licencë të mësimdhënësit mentor për një periudhë prej së paku 10 vitesh;
 - 1.2.** ka përfunduar së paku 650 orë trajnim gjatë karrierës, nga këto së paku 400 orë nga programet themelore të trajnimit, ndërsa të tjerat nga programet plotësuese të trajnimit, dhe
 - 1.3.** tregon rezultate pozitive të performancës (nivel të shkëlqyeshëm të performancës).
- 2.** Licenca e mësimdhënësit të merituar është e përhershme.

Neni 17**Kalimi në nivel më të ulët dhe revokimi i licencës**

1. Mësimdhënësit kalojnë në nivel më të ulët të licencës nëse nuk i plotësojnë kërkesat për ripërtëritje të licencës aktuale. Mësimdhënësit me licencë të rregullt të karrierës në rastet kur nuk plotësojnë kërkesat sipas dispozitave të këtij UA kalojnë në licencë të përkohshme.
2. Mësimdhënësve mund t'iu merret licenca që kanë, me kërkesë të Drejtorive Komunale për shkak të procedurave disiplinore. Në rastet kur mësimdhënësit e tillë kthehen përsëri në profesionin e mësimdhënies duhet të kthehen në licencë të përkohshme.

Neni 18**Aplikimi për licencim, ripërtrirje dhe avancim të licencës**

1. Secili individ duhet të aplikoj për licencë sipas dispozitave të këtij UA para se të hyjë në profesionin e mësimdhënies.
2. Mësimdhënësit janë përgjegjës që individualisht të aplikojnë për ripërtrirje dhe avancim të licencës.
3. Mësimdhënësit aplikojnë për ripërtrirje dhe avancim të licencës 6-12 muaj para se të skadojë licenca aktuale.
4. Mësimdhënësit aplikojnë për ripërtrirje dhe avancim të licencës në Zyrën e Departamentit të Inspektionit të MASHT-it nën autoritetin e së cilës është komuna ku punon mësimdhënësi.
5. Për secilin aplikacion zbatohet një pagesë prej 25 € apo ndonjë shumë tjetër që mund të specifikohet nga MASHT në të ardhmen.
6. Së bashku me Formularin e Aplikimit mësimdhënësit duhet të sigurojnë dëshmi origjinale për të gjitha informatat e specifikuar në formular.
7. Departamenti i Inspektionit vendos të dhënat e licencimit për mësimdhënësit individual në databazën e licencimit.
8. Vendimi rreth aplikacionit të mësimdhënësit për ripërtrirje të licencës duhet të merret para skadimit të licencës aktuale.
9. Në rastet kur mësimdhënësi aplikon për ripërtrirje ose avancim të licencës brenda afatit kohor të specifikuar në nenin 18, por, vendimi nuk është marrë para skadimit të licencës aktuale, mësimdhënësit i vazhdohet automatikisht licenca aktuale edhe për 6 muaj. Vendimi i tillë duhet të shoqërohet me një arsyetimi të shkruar nga Departamenti i Inspektionit ku sqarohen arsyet e mospërfundimit të procedurës me kohë.
10. Në rastet kur vendimi nuk merret 6 muaj pas skadimit të licencës, drejtori i Departamentit të Inspektionit do të nisë procedurën për konstatimin e përgjegjësisë. Deri në marrjen e vendimit, licenca aktuale e mësimdhënësit mbetet e vlefshme.

Neni 19**Formati i licencimit**

1. MASHT-i i lëshon një numër secilit mësimdhënësit të licencuar dhe një licencë në formë letre që specifikon periudhën e vlefshmërisë, llojin e licencës si dhe të dhënat personale të mësimdhënësit të licencuar.

Neni 20**Ndërlidhja e sistemit të pagave me sistemin e licencimit**

1. Sistemi i licencimit të mësimdhënësve ndërlidhet me sistemin e pagave. Sistemi i pagave zbatohet sipas vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 01/33 të datës 29.08.2008 dhe në të ardhmen do të përshtatet sipas dispozitave relevante në fuqi.
2. Avancimi i mësimdhënësve në sistemin e licencimit ndërlidhet gjithashtu me ngritje të pagës që do të rregullohet me dispozita të tjera ligjore dhe/ose nënligjore.

Neni 21**Dispozitat kalimtare**

1. Të gjithë mësimdhënësit të cilët sipas nenit 11 të këtij UA kanë marrë licencë të mësimdhënësit të karrierës duhet të aplikojnë për marrjen e licencës së tyre dhe futjen e të dhënave në bazën e të dhënave të licencimit në periudhën janar 2011 – qershor 2011.
2. Në fazën fillestare të licencimit, janar 2011 –gusht 2011, mësimdhënësit ekzistues që kanë marrë licencë të mësimdhënësit të karrierës sipas këtij UA mund të aplikojnë për licencë të mësimdhënësit të avancuar dhe/ose licencë të mësimdhënësit mentor, pa pasur nevojë të presin afatin e rregullt kohor të specifikuar në këtë UA.
3. Mësimdhënësit që aplikojnë për avancim në sistemin e licencimit sipas nenit 21.2 mund të llogarisin zhvillimin profesional të ndjekur në të kaluarën drejt kërkesave për zhvillim profesional (trajnim) për licencën përkatëse, me kusht që programet e trajnimit të akreditohen nga KSHLM.
4. Mësimdhënësit të cilët nuk i kanë orët e mjaftueshme të zhvillimit profesional nga e kaluara mund të aplikojnë për avancim në sistemin e licencimit sipas nenit 21.2 nëse kanë 15 vite përvojë pune në momentin e aplikimit për licencën e mësimdhënësit të avancuar dhe 20 vite përvojë pune në momentin e aplikimit për licencën e mësimdhënësit mentor.
5. Mësimdhënësit të cilët aplikojnë për avancim në karrierë sipas dispozitave kalimtare të këtij UA, në rastet kur marrin vlerësim negativ të njëjtëve ju ndalohet riaplikimi për 5 vitet e ardhshme.

Neni 22**E drejta e ankesës**

1. Ankesat ndaj procesit të licencimit mund të bëhen në Komisionin për Ankesa dhe Parashtresa në MASHT.

Neni 23**Dispozitat shfuqizuese**

1. Me hyrjen në fuqi të këtij UA shfuqizohen UA 16/2008, UA 33/2007, si dhe dispozitat e tjera që kanë rregulluar këtë fushë e që janë në kundërshtim me këtë UA.

Neni 24**Hyrja në fuqi**

1. Ky Udhëzim administrativ hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë.

Enver Hoxhaj, ministër

Shtojca I

Kualifikimet e mësimdhënësve në sistemin e licencimit

Në sistemin e licencimit të mësimdhënësve do të merret për bazë gjendja aktuale e shkollimit të mësimdhënësve në Kosovë, në veçanti në lidhje me kërkesat e hyrjes së mësimdhënësve në profesion.

Kualifikimet në vijim do të pranohen në sistemin e licencimit dhe mësimdhënësit përkatës do të konsiderohen të kualifikuar për pozitën përkatëse:

Klasifikimi i kualifikimeve ekzistuese

Niveli 0 i ISCED-it

1. Shkolla e mesme e mjekësisë: motra edukatore – niveli parashkollor, mosha 0-3
2. Programi parashkollor i ish-Shkollave të Larta Pedagogjike, Fakultetit të Mësuesisë, dhe Fakultetit të Edukimit – mosha 3-6s.

Niveli 1 i ISCED-it

1. Programi i ish- Shkollës Normale
2. Programi fillor i ish- Shkollave të Larta Pedagogjike
3. Programi fillor i ish- Fakultetit të Mësuesisë;
4. Programi fillor i Fakultetit të Edukimit
5. Programi i Pedagogjisë (e përgjithshme) në Fakultetin Filozofik do të pranohet vetëm për mësimdhënësit që tashmë janë në sistem, ndërsa mësimdhënësit që vijnë të rinj me një kualifikim të tillë nuk do të konsiderohen të kualifikuar për mësimdhënie.

Niveli 2 i ISCED-it

1. Programet lëndore të ish- Shkollave të Larta Pedagogjike
2. Programet lëndore të Fakultetit të Edukimit
3. Diplomat e lëshuara nga departamentet akademike (Matematikë dhe Shkenca, Filologji, Filozofi, Artet, Edukatë Fizike).

Niveli 3 i ISCED-it

1. Diplomat e profilit arsimor të lëshuara nga departamentet akademike (Matematikë dhe Shkenca, Filologji, Filozofi, Artet, Edukatë Fizike)
2. Diplomat e lëshuara nga Fakultetet joarsimore (Fakultetet Teknike, Juridiku, Mjekësia, Ekonomia)
3. Për pozitën e instruktorit në shkollat profesionale, kualifikimet e nivelit ISCED 3 janë gjithashtu të pranueshme.

Shënim 1: Mësimdhënësit me kualifikimet më lartë janë të kualifikuar vetëm nëse punojnë si mësimdhënës të lëndës/ve për të cilën është lëshuar diploma dhe nivelin që është përcaktuar në Shtojcë të këtij UA.

Shënim 2: Diplomat e lëshuara nën ndonjë sistem ose strukturë tjetër, duke përfshirë edhe diplomat e lëshuara jashtë vendit, do të kategorizohen sipas klasifikimit më lartë, pasi ato të jenë njohur paraprakisht përmes mekanizmave në fuqi.

Shënim 3: Diplomat të cilat nuk mund të kategorizohen përmes kësaj shtojce do të shqyrtohen në bazë individuale nga KSHLM.

Shënim 4: Miratimi i programeve që shpijnë drejt kualifikimit të mësimdhënësit, dhe përcaktimi i standardeve për programet që përgatisin mësimdhënës, rregullohen përmes ligjeve dhe akteve tjera nënligjore.

Aneksi B - Vlerësimi për të nxënë

Një tregim i vërtetë

Pas dymbëdhjetë vjet shkolle dhe gjashtë vjet në universitet nuk mbaj mend ndonjë gjë që kam mësuar në lidhje me përgatitjet për provimin përfundimtar (vlerësimin përmblendës). Por, e mbaj mend, sikur të ishte tani, përvojën time të parë me vlerësimin formësues. Ma ofroi babai (i cili nuk ishte mësues).

Familja ime po përgatitej për pushimin e parë që e kishte bërë ndonjëherë larg shtëpisë. I kisha dhjetë (10) vjet. E kishim një automobil të vogël, i cili nuk i zinte të gjitha valixhet. Kështu që babai vendosi ta ndërtonim një arkë të hapur për valixhe dhe ta vendosnim në mbajtëset e sipërme të automobilit. Më pyeti nëse më pëlqente ta dizajnoja dhe mi dha specifikat:

1. I kishim dy dërrasa të cilat ishin 2.5 metra të gjata, 2 centimetra të trasha dhe 30 centimetra të gjera. Këto dy dërrasa do të bëheshin pjesët anësore të arkës.
2. Pjesa e poshtme e arkës duhej të ishte me dërrasa më të holla me hapësirë ndërmjet veti që do të mundësonin kullimin e shiut nga arka në kulmin e automobilit në rast se na zinte shiu rrugës.
3. Dërrasat e holla do të formonin bazën e arkës, dhe se arka do të montohej me anë të lidhëseve dado. Duhej t'i bënim 8 dërrasa të shkurtra prej 3 copave të dërrasave që ishin 2.5 metra të gjata, 2 centimetra të trasha dhe 10 centimetra të gjera.

Kështu që i fillova t'i bëja llogaritjet dhe ta dizajnoja; "do të ishte një punë e lehtë, kështu mendoja". Pasi ia fillova të punojë e pash se nevojitej më shumë sesa kisha menduar. Babai nuk më tha asnjëherë "Këtë e ke gabim". Ai do të më parashtronte pyetje si, "nëse do ta bësh arkën kaq të gjerë a do të përshtatej me hapësirën e mbajtëseve? "Nëse do t'i bësh dërrasat më të holla aq të gjata, a do të na mjaftojnë dërrasat? A më bënte vazhdimisht pyetje të cilat më bënin të mendohem 'brenda kontekstit'. Me fjalë të tjera, ai i referohej gjithnjë kriterëve që i kishim vendosur, si të ishin objektivat mësimore në një orë mësimi. Brenda një dite e kisha dizajnuar arkën. Dizajni funksionoi dhe e ndërtoam së bashku arkën. Isha shumë krenar dhe i gëzuar se "e kisha bërë atë". Gjatë gjithë kohës po mësoja nën udhëzimet e babait.

Vlerësimi formësues – vlerësimi për të nxënë

Ajo që kishte bërë babai im ishte përdorimi klasik i vlerësimit formësues. Mësimdhënësit duhet ta bëjnë këtë gjë me nxënësit e tyre po ashtu.

- Ai gjatë gjithë kohës me inkurajonte dhe më ofronte komente dhe sugjerime të cilat nuk gjykonin, kishin fokus të qartë dhe ishin përshkruese.
- Më angazhoi në procesin e dizajnit.

- Më ndihmoi t'i gjej gabimet e mia, sigurohej që i kuptoja kufizimet që i kishim dhe sigurohej që ta dija se cili ishte hapi tjetër. Po e krahasoja punën time me një qëllim; sigurohej që e kuptoja qëllimin (specifikimet e dizajnit).
- I merrja veprimet për t'i korrigjuar gabimet.
- E zotëroja procesin tim të mësimin.

Vlerësimi formësues është instrumenti më i fuqishëm i vlerësimit i cili gjeneron mësim. Ai "...i jep mundësi nxënësit të bëhet nxënës pa frikën se do të dështojë. Krijohet një mjedis mësimor dhe ofrohen mundësi për nxënësit t'i praktikojnë shkathtësitë dhe të marrin komente specifike dhe përshkruese që u ndihmojnë ta përmirësojnë të mësuarit."¹¹ Ky instrument, jo vetëm që është i fuqishëm sa i përket të nxënësit, por është edhe një instrument diagnostikues për mësimdhënësit. Të dish nëse nxënësit janë duke i përvetësuar shkathtësitë dhe duke i kuptuar konceptet të cilat zhvillohen u ndihmojnë mësimdhënësve që të vendosin se çfarë të bëjnë më tutje. **Mësimdhënia nuk ka të bëjë vetëm me ofrimin përmbajtjes; ka të bëjë me angazhimin e nxënësve në aktivitete që i bën të mësojnë.**

Përmes vlerësimit formësues, mësimdhënësit krijojnë një mjedis të kërkimit duke parashtruar pyetje të cilat i provokojnë mendimet dhe duke i inkurajuar nxënësit që ta bëjnë gjënë e njëjtë. Nxënësve u jepet mundësia t'i eksplorojnë dhe hulumtojnë problemet apo sfidat e hapura. Të nxënësit e mirëfilltë ndodh pasi nxënësi të ketë qasje në informacionin e duhur me qëllim të zgjidhjes së problemit apo sfidës, të kenë mundësin të mendojnë në mënyrë kritike dhe kreative, të parashtrojnë pyetje, t'i sfidojnë supozimet, të bëjnë dhe t'i testojnë nënkuptimet, dhe të angazhohen në dialog sa i përket mësimin. Një mjedis i tillë i inkurajon nxënësit të marrin rol aktiv në orientimin dhe përqendrimin e të nxënësit të tyre.¹²

Meqë vlerësimi për të nxënë (vlerësimi formësues) është një instrument i fuqishëm i të nxënësit, atëherë drejtorët duhet ta inkurajojnë përdorimin e tij. Në fakt, drejtorët duhet të presin që ai të përdoret prej të gjithë mësimdhënësve në shkollë pa marrë parasysh lëndën të cilën e japin. Drejtori nuk është e thënë të jetë ekspert as në lëmin përkatëse e as në vlerësim. Drejtori duhet të dijë mjaftueshëm që t'ua parashtrojë pyetjet e duhura mësimdhënësve të tij.

Thelbi i vlerësimit për të nxënë është komenti apo informacioni kthyes. Çfarë duhet të shihni kur ta vizitoni klasën? Cilat sjellje të mësimdhënësit duhet të vëzhgohen më së shpeshti? Lista në vijim me karakteristikat dhe format e komenteve kthyesë janë kopjuar nga kapitulli 10 i Susan M. Brookhart në C.F. Webber dhe J. L. Lupart (eds.), (2011) *Leading Student Assessment*, Studies in Educational Leadership (ang: Udhëheqja e vlerësimit të nxënësve: studime në udhëheqjen në arsim).

Komentet e mësimdhënësit nuk e garantojnë të nxënësit; andaj, ajo çka janë komentet kthyesë dhe mënyra si ofrohet e stimulojnë veprimin e nxënësit.

- Jep komente të menjëhershme për njohuritë dhe faktet (e drejtë/e gabuar).
- Lejo pak më shumë kohë për të mundësuar një analizë më gjithëpërfshirëse të të menduarit dhe proceseve nga ana e nxënësit.
- Mos i vono asnjëherë komentet kthyesë përtej asaj se kur mund të ndikojnë tek nxënësi.
- Jep komente kthyesë sa herë që të jetë praktike, dhe sidomos për të gjitha detyrat më të mëdha.

¹¹ Sherry Bennett and Dale Armstrong; *Putting the Focus on Learning: Shifting Classroom Assessment Practices* (Chapter 13) f. 265

¹² Ibid; f. 269

- Vendimi për sasinë e komenteve përfshijnë pikët që duhet të jepen dhe sasinë që duhet të thuhet për secilën pikë.
- Vëni në prioritet komentet kthyes: jepni komente për pikat më kryesore.
- Zgjidhni pikat që lidhen me qëllimet kryesore të të nxënës.
- Kini parasysh nivelin e zhvillimit të nxënës.

Zgjidhni metodën më të mirë për ta përçuar mesazhin.

- **Komentet kthyes ndërvepruese** (biseda me nxënësin) është metoda më e mirë kur kjo është e mundshme.
- Përdorni metodën e **komenteve në formë të shkruar**, duke dhënë komente në një detyrë apo në një fletë të veçantë.
- Përdorni **demonstrimin** nëse “si të bëhet diçka” përbën problemin e çështjes, ose nëse nxënësi ka nevojë për shembull.

Bëjeni komentin kthyes më tepër përshkruar sesa gjykues.

Mësimdhënësit duhet të vendosin për audiencën sa i përket dhënies së komenteve kthyes, pra nëse dëshirojnë t'i bëjnë komentet për nxënësit veç e veç, për një grup të vogël, apo për tërë klasën. Rekomandimet janë si në vijim:

- Jep komente individuale për të komunikuar, “Mësimdhënësi e vlerëson të nxënës tim”.
- Jep komente grupore ose për tërë klasën nëse shumica e klasës nuk e ka kuptuar konceptin e një detyre; kjo paraqet një mundësi për përsëritje të mësim.
- Fokusi i komenteve kthyes:
- Kur të jetë e mundur, përshkruajeni si punën ashtu edhe procesin, si dhe marrëdhëniet mes të dyjave.
- Jepni komente lidhur me vetë-rregullimin nga ana e nxënësit nëse komentet e tilla do ta nxisin vet-efikasitetin.
- Shmanguni prej komenteve personale.

Hattie dhe Timperley e kanë propozuar një model të komenteve kthyes që shkon në katër nivele: komente për detyrën (p.sh. komente kthyes nëse përgjigjet ish-in të sakta apo të gabuara, ose orientim për të marrë më shumë informacione), komente për procesin e detyrës (p.sh. komente kthyes lidhur me strategjitë e përdorura apo për strategjitë që mund të përdoren), komente për vetë-rregullim (p.sh. komente lidhur me vetë-vlerësimin apo vetëbesimin e nxënësit), dhe komente për nxënësin si person (p.sh., deklarime se nxënësi është ‘i mirë’ ose ‘i mençur’). Analiza e tyre vë në pah se niveli në të cilin është përqendruar komenti kthyes ndikon në efektivitetin e tij. Komentet kthyes për cilësinë e detyrës dhe komentet për procesin ose strategjitë e përdorura për kryerjen e detyrës janë më të dobishmet. Komentet që e tërheqin vëmendjen e nxënësve për strategjitë vetë-rregulluese apo aftësitë e tyre si nxënës mund të jenë efektive nëse nxënësit e kuptojnë se do t'i rrisin rezultatet në qoftë se dëshirojnë t'i shtojnë përpjekjet dhe t'i kushtojnë më shumë vëmendje. Komentet personale (“Vajzë e mirë!”) nuk e tërheqin vëmendjen e nxënësit për të nxënës e tyre.¹³

Ofrimi i komenteve kthyes nuk ka të bëjë me dhënien e lëvdatave; ajo ka të bëjë me ri-orientimin dhe përqendrimin e veprimeve të nxënësit karshi të nxënës/mësim.

¹³ Susan M. Brookhart; “TeacherFeedback in FormativeClassroomAssessment” f. 232

Veçantia e komenteve kthyese:

- Përshatjani elementet e komenteve nxënësit dhe detyrës.
- Komentet duhet të jenë specifike në atë masë sa nxënësi të dijë se çfarë të bëjë, por jo edhe aq specifike sa të duket se është bërë në vend të tij/saj.
- Identifikoni gabimet ose llojet e gabimeve, por korrigjimi i secilit gabim (p.sh., korrigjimi apo ofrimi i përgjigjeve të sakta) nuk i lë vend nxënësit që të bëjë ndonjë gjë.

Për të mësuar më shuam se çfarë duhet të bëjnë mësimeve me nxënësit e tyre për ta stimuluar mësimin më shumë tek ta, ju lutem konsultohuni me materialet e Programit të Arsimit Themelor (PATH) që i keni në memorien e USB-së. Nëse do të ketë ndonjë program trajnimi të ofruar nga PATH në rajonin tuaj, do të ishte e mirë që ju si drejtor shkolle të shkoni në atë trajnim. Ka shumë gjëra për të mësuar dhe për të bërë me qëllim që të mbështeten mësimeve e Kosovës në përpjekjet e tyre për stimulimin një mësimi të atillë të nxënësve të tyre që i përmbush pritjet e Kornizës së re të kurrikulumit të Kosovës.

Shtojca II

Tabela në faqe 26

Vlerësimi i Mësimnxënies së Nxënësve në Klasë

Çmuarja, vlerësimi dhe komunikimi

Planifikimi

Programi i studimit: Rezultatet mësimore

Çka do të mësojnë nxënësit?

Si do ta dimë se ka ndodhur mësimnxënia?

- vendosni kritere/tregues
- ofroni shembuj

Si do t'i mbledhin dhe sigurojmë provat për mësimnxënie?

- vendosni qëllimin dhe kontekstin
- krijoni mundësi për të demonstruar mësimnxënien
- vëzhgimet
- ditarët e mësimnxënies
- detyrat e performancës
- projektet
- testet
- gjuha e shkruar
- gjuha verbale
- komunikimi vizuel
- vendosni strategji për informata kthyese

Cilat aktivitete do t'iu mundësojnë nxënësve të mësojnë?**Si do ta demonstrojnë nxënësit mësimnxënien e tyre?****Si do të marrin nxënësit informata kthyesë të vazhdueshme?**

- përshkruese
- specifike
- vetë/kolegu/prindi/mentori/ mësimdhënësi si mentor
- vlerësimi PËRmësimnxënie

Cilët do të jenë hapat e ardhshëm në mësimnxënie?**Si do t'i marrin nxënësit informatat kthyesë sumative?**

- kualitative/përshkruese
- kuantitative/nota
- vetë/mësimdhënësi si gjykues
- vlerësimi i mësimnxënies

Cilët do të jenë hapat e ardhshëm në mësimnxënie

- vetë-reflektim/reflektim i mësimdhënësit
- vënia e synimeve

© Konsorciumi për Vlerësim i Albertas

Burimi: Korniza për Vlerësimin e Nxënësve, botimi i dytë, (2005)

www.aac.ab.ca